23.6 Pas pranimit të përkohshëm të furnizimeve, Furnizuesi i çmonton dhe i heq strukturat e përkohshme dhe materialet që nuk kërkohen më për përdorim përkritazi me realizimin e kontratës. Ai gjithashtu do të heqë ndonjë mbeturinë apo pengesë dhe të bëjë ndonjë ndryshim të gjendjes së vendit të pranimit siç kërkohen në kontratë.

Neni 24 Obligimet për garanci

24.1 Furnizuesi do të garantojë që furnizimet të jenë të reja, të papërdorura, të modeleve të fundit dhe të përfshijë të gjitha përmirësimet e kohëve të fundit në dizajn dhe materiale, përveç nëse kërkohet ndryshe në kontratë. Furnizuesi do të garantojë që asnjë nga furnizimet të mos kenë defekt që shkaktohet nga dizajni, materialet apo mjeshtëria. Kjo garanci do të mbetet e vlefshme në atë mënyrë që saktësohet në KVK.

24.2 Furnizuesi do të jetë përgjegjës për mënjanimin e defekteve, ose dëmeve në ndonjë pjesë të furnizimeve të cilat mund të paraqiten, apo të ndodhin gjatë periudhës së garancisë dhe të cilat:

- a) rezultojnë nga përdorimi i materialeve defektive, mjeshtërisë së gabueshme ose dizajnit jo të mirë nga Furnizuesi; ose
- b) rezultojnë nga veprimet ose mosveprimet e Furnizuesit gjatë periudhës së garancisë; ose
- c) shfaqen gjatë ndonjë inspektimi të bërë nga Autoriteti kontraktues ose në emër të tij.

24.3 Furnizuesi me shpenzime të veta do ta përmirësojë defektin ose dëmin sa më shpejt që kjo të mund të praktikohet. Periudha e garancisë për të gjithë artikujt e ndërruar ose të riparuar do të fillojë përsëri nga data në të cilën është bërë

ndërrimi ose riparimi sipas vlerësimit të autoritetit kontraktues. periudha e garancisë do të vazhdohet vetëm për atë pjesë të furnizimeve që është ndikuar nga ndërrimi apo riparimi.

24.4 Nëse shfaqet ndonjë defekt ose ndodh ndonjë dëm gjatë periudhës së garancisë, autoriteti kontraktues do ta lajmërojë k Furnizuesin. Nëse Furnizuesi nuk arrin ta kompensojë dëmin nga ndonjë defekt ose një dëm brenda afatit kohor të paraparë në njoftim, autoriteti kontraktues mund të:

- a) të korrigjojë defektin apo dëmin vetë, ose të punësojë dikë tjetër për ta bërë punën në rrezikun dhe me shpenzimet e Furnizuesit, në të cilin rast kostoja e shkaktuar nga autoriteti kontraktues do të zbritet nga paratë që duhet të paguhet ose garancitë që mbahen prej Furnizuesit ose nga të dy;
- b) në rast se nuk ka sasi të duhur ose asnjë garanci nuk është efektive kërkon që të merrni shumën e duhur nga Furnizuesi; ose
- c) të ndërpresë kontratën.

24.5 Obligimet e mirëmbajtjes do të parashihen në KVK dhe në specifikimet teknike. Nëse kohëzgjatja e periudhës së garancisë nuk është e specifikuar, ajo do të jetë 365 ditë. Periudha e garancisë do të fillojë në datën e pranimit të përkohshëm.

Neni 25 Shërbimet pas-shitjes

25.1 Shërbimet pas-shitjes, nëse kërkohe në kontratë, do të jepen në pajtim me të dhënat e parapara në KVK. Furnizuesi do të marrë përsipër të realizojë ose të organizojë realizimin e mirëmbajtjes dhe të riparimit të furnizimeve dhe të sigurojë shpejt pjesët rezervë. KVK mund të saktësojë që Furnizuesi të sigurojë ndonjë ose të gjitha materialet e mëposhtme, njoftimet dhe dokumentet që kanë të bëjnë me pjesët rezervë që i prodhon apo i distribuon Furnizuesi:

- a) pjesët rezervë të cilat Autoriteti kontraktues mund të vendosë t'i blejë nga Furnizuesi, duke kuptuar që ky vendim nuk do ta lirojë Furnizuesin nga obligimet e garancisë sipas kontratës
- b) në rast të ndërprerjes së prodhimit të pjesëve rezervë, duhet të lajmërohet paraprakisht Autoriteti kontraktues për t'i mundësuar që të blejë pjesët e kërkuara dhe, pas ndërprerjes, skicat, vizatimet dhe specifikimet e pjesëve rezervë, nëse kërkohe dhe kur kërkohe do t'i sigurohen Autoriteti kontraktues pa pagesë.

Neni 26 Pranimi përfundimtar

26.1 Pas skadimit të periudhës së garancisë ose, në rastet kur ka më tepër se një periudhë, pas skadimit të periudhës së fundit, dhe atëherë kur të jenë zgjidhur të gjitha defektet apo dëmet, autoriteti kontraktues do t'i lëshojë Furnizuesit një certifikatë të pranimit përfundimtar, me një kopje Autoritetit kontraktues, duke cekur datën në të cilën Furnizuesi i ka plotësuar obligimet e tij sipas kontratës dhe në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktues të jetë i kënaqur. Certifikata finale e pranimit do të lëshohet nga autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga skadimi i periudhës së garancisë ose menjëherë pasi riparimet eventuale që janë kërkuar sipas Nenit 24 të jenë përfunduar në mënyrë të tillë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

26.2 Kontrata nuk do të konsiderohet se është realizuar plotësisht derisa të jetë nënshkruar certifikata përfundimtare e pranimit ose derisa të konsiderohet se kjo është nënshkruar nga autoriteti kontraktues.

26.3 Pa marrë parasysh lëshimin e certifikatës përfundimtare, Furnizuesi dhe autoriteti kontraktues do të mbeten të detyruar për plotësimin e obligimeve që dalin sipas kontratës para lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimit dhe të cilat kanë mbetur të përcaktuara në kohën kur lëshohet certifikata përfundimtare e pranimit. Natyra dhe masa e obligimeve të tilla do të përcaktohen duke iu referuar dispozitave të kontratës.

Neni 27 Shkelja e kontratës

27.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë.

27.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
- b) ndërprerjen e kontratës.

27.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

27.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhet Furnizuesit, nga depozita, ose me pagesë nga siguria.

Neni 28 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

28.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Furnizuesit 14 ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet e mëposhtme:

- a) kur Furnizuesi në mënyrë përmbytëse nuk arrin t'i realizojë obligimet e veta sipas kësaj kontrate;

- b) Furnizuesi dështon në përmbushjen brenda një afati të arsyeshëm të paralajmërimit të dhënë nga autoriteti kontraktues që kërkon nga ai të evitojë ndonjë neglizhencë apo dështim për të realizuar obligimet e veta sipas kontratës, dhe të cilat ndikojnë në mënyrë serioze në realizimin e duhur dhe me kohë të punëve;
- c) Furnizuesi refuzon ose është neglizhent në realizimin e urdhrave administrative të dhëna nga autoriteti kontraktues;
- d) Furnizuesi ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga Autoriteti kontraktues;
- e) Furnizuesi falimenton ose është duke u mbyllur; punët e tij janë duke u administruar nga gjykatat, ka hyrë në marrëveshje me kredituesit, ka pezulluar aktivitetet biznesore, i nënshtrohet procedurave ligjore lidhur me ato çështje, ose është në ndonjë situatë analoge që shkaktohet nga ndonjë procedurë e ngjashme e paraparë në legjislacionin apo në rregulloret nacionale;
- f) Furnizuesi është dënuar për një shkelje që ka të bëjë me sjelljen profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res judicata*;
- g) Furnizuesi është shpallur fajtor për sjellje të rëndë të keqe jo profesionale të dëshmuar me çfarëdo mjete të cilin mund ta vërtetoj Autoriteti kontraktues;
- h) Furnizuesi i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat financiare të Komuniteteve;
- i) Furnizuesi , pas një procedure tjetër të prokurimit ose procedure të dhënies së një granti të financuar nga buxheti i komunitetit, është deklaruar se ka bërë shkelje serioze të kontratës për mosrealizim të obligimeve të veta kontraktuese;
- j) të gjitha modifikimet organizative që përfshijnë ndryshime në personalitetin ligjor, natyrën ose kontrollin e Furnizuesit, përveç nëse këto modifikime regjistrohen në suplementin e kontratës;
- k) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimin të kontratës;
- l) Furnizuesi nuk arrin të japë garancinë ose sigurimin e kërkuar, ose nëse personi që e jep garancinë apo sigurimin më të hershëm të kërkuar në kontratën e tanishme nuk është në gjendje t'i plotësojë zotimet e tij.

28.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim ndaj të drejtave apo mundësive tjera të Autoritetit kontraktues dhe Furnizuesit sipas kontratës. Autoriteti kontraktues, pas kësaj mund të nënshkruajë ndonjë kontratë tjetër me një palë të tretë në emër të Furnizuesit. Detyrimi i Furnizuesit për të shtyrë përmbushjen duhet të pushojë së ekzistuari menjëherë pas ndërprerjes, pavarësisht nga detyrimet që mund të jenë paraqitur tashmë.

28.3 Autoriteti Kontraktues, pas lëshimit të njoftimit të ndërprerjes së kontratës, do ta udhëzojë Furnizuesin që të ndërmarrë hapa të menjëhershëm për ta përmbyllur ekzekutimin e furnizimeve në mënyrë të shpejtë dhe të rregullt dhe për t'i zvogëluar në minimum shpenzimet.

28.4 Në rast të ndërprerjes, autoriteti kontraktues, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në prani të Furnizuesit ose të përfaqësuesve të tij ose duke u bërë atyre thirrjen e duhur, do ta përgatisë një raport mbi furnizimet e dorëzuara dhe punës së realizuar dhe të bëjë rëxhistrimin e materialeve të furnizuara dhe të papërdorura. Do të përgatitet edhe një deklaratë e parave që duhet t'i paguhen Furnizuesit dhe parave që i ka borxh Furnizuesit Autoritetit kontraktues në datën e ndërprerjes së kontratës.

28.5 Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i obliguar të bëjë pagesa tjera për Furnizuesin derisa të jenë përfunduar furnizimet, ndërsa Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë të marrë nga Furnizuesi koston ekstra, nëse ka, të furnizimeve ose do të paguajë shumën që duhet t'i paguhet Furnizuesit para ndërprerjes së kontratës.

28.6 Nëse Autoriteti kontraktues e ndërpret kontratën, ai do të ketë të drejtë të marrë nga Furnizuesi humbjet që i janë shkaktuar nën kushtet e kontratës të parapara në Nenin 2 të KVK.

Neni 29 Ndërprerja nga ana e Furnizuesit

29.1 Furnizuesi , pasi e ka paralajmëruar Autoritetin kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues:

- nuk arrin t'i paguajë Furnizuesit shumat që duhet të paguhen në ndonjë certifikatë të lëshuar nga personi i autorizuar pas skadimit të afatit të fundit.
- vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta edhe pas rikujtimeve të përsëritura; ose
- e pezullon dorëzimin e furnizimeve, ose ndonjë pjesë të tyre, për më tepër se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk mund t'i atribuohen Furnizuesit.

29.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim për ndonjë të drejtë apo autoritet tjetër sipas kontratës së Autoritetit kontraktues dhe Furnizuesit.

29.3 Në rast të ndërprerjes sipas paragrafit (a) dhe (b) të Seksionit 29.1 , Autoriteti kontraktues do ta paguajë Furnizuesin për humbje ose dëm që mund t'i jetë shkaktuar Furnizuesit.

Neni 30 Forca madhore

30.1 Asnjëra palë nuk konsiderohet se ka bërë mosrespektim ose shkelje të obligimeve të saj sipas kontratës nëse realizimi

i obligimeve të tilla parandalohet nga ndonjë ngjarje e shkaktuar nga një *forcë madhore* që shkaktohet pas datës kur kontrata hyn në fuqi.

30.2 Për qëllime të këtij Neni, termi "forcë madhore" do të thotë veprimet e zotit, goditjet, mbylljet e objektit ose çrregullimet tjera industriale, veprimet e armikut publik, luftërat qofshin të deklaruara ose jo, bllokadat, rebelimet, rastet e dhunës, epidemitë, rrëshqitjet e tokës, tërmetet, shtrëngatat, vetëtimat, vërshimet, erozionet, trazirat civile, eksplozionet dhe ndonjë ngjarje tjetër e ngjashme e paparashikuar që është përtej kontrollit të palëve dhe nuk mund të përballohet as me kujdesin e duhur.

30.3 Pa marrë parasysh dispozitat e Neneve 16 dhe 28, Furnizuesi nuk do të jetë i detyruar të heqë dorë nga garancia e realizimit, dëmet e likuiduara ose ndërprerja për shkak të shkeljes nëse, dhe deri në atë masë sa, vonesa e tij e realizimit ose mënyrë tjetër dështimi për të realizuar obligimet e tij me kontratë është rezultat i një ngjarjeje të forcës madhore. Gjithashtu, pa marrë parasysh dispozitat e Neneve 20.5 dhe 29, Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i detyruar të paguajë interes për pagesat e vonuara, për mosrealizim ose për ndërprerje nga Furnizuesi për shkelje të kontratës, nëse dhe deri në atë masë sa vonesa e Autoritetit kontraktues ose lloj tjetër i dështimit për të kryer obligimet e tij është rezultat i forcës madhore.

30.4 Nëse ndonjëra palë konsideron se ndonjë rrethanë e forcës madhore ka ndodhur e cila mund të ndikojë në realizimin e obligimeve të saj, menjëherë do ta lajmërojë palën tjetër, duke dhënë të dhëna detaje mbi natyrën, kohëzgjatjen e mundshme dhe efektin që kanë gjasa ta kenë rrethanat. Përveç nëse udhëzohet ndryshe nga autoriteti kontraktues me shkrim, Furnizuesi do të vazhdojë t'i realizojë obligimet e tij sipas kontratës përderisa është mjaft praktike, dhe të angazhojë të gjitha mjetet e arsyeshme alternative për të plotësuar ndonjë obligim që ngjarja e forcës madhore të mos e pengojë atë gjatë punës. Furnizuesi nuk do të zbatojë mjete të tilla alternative përveç nëse udhëzohet ta bëjë këtë nga autoriteti kontraktues.

30.5 Nëse Furnizuesi shkaktonte kosto plotësuese gjatë zbatimit të urdhrave të autoritetit kontraktues ose gjatë përdorimit të mjeteve alternative sipas nenit 30.4 shuma e saj do të certifikohet nga autoriteti kontraktues.

Neni 31 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

31.1 Palët duhet t'i bëjnë të gjitha përpjekje për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për qëndrimet e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

31.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 32 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

32.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi; ose
- b) kurdo që palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK..

32.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

KUSHTET E VEÇANTA

Numri i kontratës: **635-26-1742-1-1-1/C1308**

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë Gjuha Shqipe
Siguria e ekzekutimit	8.1	Sigurimi i ekzekutimit 10 % e vlerës së kontratës (nga banka apo kompanitë e sigurimeve) ne shume prej 69.745.00 euro me afat nga data 29.06.2026 deri me datë 13.09.2026
Sigurimi	9.1	Incotermi i aplikueshëm është DDP (Delivery Duty Paid).
Cilësia e furnizimeve	16.2	Autoriteti Kontraktues do të refuzojë çdo dergese të materila të cilat deshton në përmbushjen e specifikimeve minimale të cilësive të përcaktuara në specifikimin teknik.
Inspektimi dhe testimi	17.2	Inspektimi dhe testimi do të kryhen me rastin e dorëzimit dhe në përputhje me Nenin 19 të Kushteve të Përgjithshme në adresat e specifikuar në Nenin 2.2 të Kontratës.
Dorëzimi	19.3	Furnizuesi do të bartë të gjitha rreziqet që kanë të bëjnë me mallrat deri në pranimin në destinacion. Furnizimet duhet të paketohen në mënyrë që të parandalohet dëmtimi i tyre deri në destinacionin e tyre. Dërgesa: Dërgesat do të bëhet brenda 45 ditëve pas marrjes së "urdhër blerjes" nga ana e Furnizuesit. Dorëzimi do të bëhet në një ditë pune dhe gjatë orarit të punës të Autoritetit kontraktues (e hënë - e premte, 8:00-16:00).
Obligimet e garancionit	22.1	<i>Garancion 12 Muaj pas Dorëzimit</i>
Menaxher i Kontrates	23.1	BURIM KELMENDI
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	29.2	Komisioni për ndërmjetësim pranë Ministrisë së Drejtësisë
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	30.1	Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykata Themelore Prishtinë, në pajtim me ligjin në Kosovë.

0074781



NUMRI I POLICËS	074781
SIGURUESI	K.S. SCARDIAN J.S.C Adresa: Rr. Perandori Justinian 3, 10000 Pristine, Kosovo
AGJENTI	Mykerem Refiku Adresa: Rr. De Rada A2 nr. 19
I SIGURUARI	N.P.T HAXHIJAH SH.P.K Adresa: RR XHELAL HAJDA, Rahovec
NUMRI I BIZNESIT	810396772
NUMRI FISKAL	810396772
QËLLIMI I SIGURIMIT	Garanci e Kontratës
PËRFITUESI	KOMUNA E PEJES
TITULLI I KONTRATËS	FURNIZIM ME MAKINERI BUJQESORE (TRAKTOR) -PARTICIPIM ME FERMERË
NUMRI I IDENTIFIKIMIT-PROKURIMIT	635-26-1742-1-1-1
TERRITORI I MBULIMIT	Republika e Kosovës
PERIUDHA E SIGURIMIT	76 ditë
SHUMA E SIGURUAR	69,745.00 EURO
Nga:	29-06-2026
Deri:	13-09-2026
PRIMI I SIGURIMIT	1255.41
TVSH 18 %	225.97
PRIMI +TVSH 18%	1481.38
DATA E LËSHIMIT	2026-06-25 11:40:10

VËREJTJE:

Polica e sigurimit të Garancive është krijuar në bazë të Ligjit Mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve Nr.04/L-077, të miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës me datë 10.05.2012, gjithashtu sipas Rregullave dhe Rregulloreve të Aprovuara nga Banka Qendore e Republikës së Kosovës. Pjesë përbërëse e kësaj police janë Kushtet e përgjithshme, pyetësori i plotësuar dhe të nënshkruar dhe çfarëdo dokumenti tjetër i bashkangjitur me me policën e sigurimit.

Kjo policë sigurimi vërteton lidhjen e kontratës, dhe lëshohet nga Siguruesi në bazë të deklarimeve dhe kërkesave të bëra nga i Siguruar/përfaqësuesi i të siguruarit, i cili është përgjegjës lidhur me saktësinë dhe vërtetësinë e deklarimeve të bëra prej tij.

Unë i Siguruar/ përfaqësuesi i të siguruarit, deklaroj se i kam lexuar me vëmendje dhe i kam kuptuar kushtet e kontratës së sigurimit, deklaroj se pajtohem me to, si dhe me të dhënat dhe përcaktimet e kësaj police sigurimi, dhe po nënshkruaj konform vullnetit tim të lirë, e të plotë.

I SIGURUARI

(emri, mbiemri, nënshkrimi)



SCARDIAN

(emri, mbiemri, nënshkrimi)

Pjesë përbërëse e policës: 074781

Për: KOMUNA E PEJES
(në vazhdim "Autoriteti Kontraktues")

Në emër të: N.P.T HAXHIJAH SH.P.K, RR XHELAL HAJDA, Rahovec
(në vazhdim "tenderuesi")

VËREJTJE:

Titulli i aktivitetit të prokurimit: FURNIZIM ME MAKINERI BUJQESORE (TRAKTOR) -PARTICIPIM ME FERMERE

Numri i prokurimit: 635-26-1742-1-1-1

SIGURIA E KONTRATËS

Garancion me kërkesë të parë

DERISA operatori ekonomik i lartcekur, ka ndërmarrë veprimet për të dorëzuar një siguri të ekzekutimit duke iu referuar Dosjes së Tenderit, me numër të prokurimit të lartcekur të dërguar nga Autoriteti Kontraktues;

DHE NGASE operatori ekonomik dëshiron të depozitojë sigurinë në shumën e saktësuar në Dosjen e tenderit;

DHE NGASE ne jemi pajtuar t'i japim operatorit ekonomik këtë siguri:

ANDAJ NE të poshtë nënshkruarit, me këtë konfirmojmë se jemi garantues dhe përgjegjës para jush, në emër të operatorit ekonomik, deri në një total prej: **69,745.00 EURO (GJASHTEDHJETE E NENTMIJE E SHATQINDE E KATERDHJETE E PESE EURO)** zotohemi të ju paguajmë, që me kërkesën tuaj të parë me shkrim në të cilën deklarohet mos përmbushja e njërit nga kushtet në vijim:

(a) Autoriteti kontraktues ka konstatuar në bazë të dëshmive të vërtetueshme objektivisht se operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe kjo i ka shkaktuar autoritetit kontraktues dëme substanciale dhe/ose shpenzime të mëdha për mbylljen e kontratës në fjalë; dhe

(b) Operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe si rezultat i saj kanë mbet pa u paguar shumë punëtorë, nënkontraktorë dhe /ose furnizues të materialeve.

Pagesa në shumën e limituar prej: **69,745.00 EURO** siç është lartcekur, do të bëhet pa asnjë kundërshtim as ankesë, sa më shpejtë që është e mundur pas regjistrimit të kërkesës suaj me konfirmimin "e pranimit".

Kjo siguri vlen 76 ditë

Data e fillimit: 29-06-2026

Emri dhe mbiemri i përfaqësuesit:



SCARDIAN Sigurime
Rr. Perandori Justinian Nr.3
10000 Prishtinë
Kosovë
2026-06-25 11:40:10





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E PEJËS
MUNICIPALITY OF PEJA
OPŠTINA PEČ



ZYRA E PROKURIMIT KOMUNA E PEJËS

KOMUNA E PEJËS
Zyrtari Kryesor Administrativ

Datë: 29.06.2026

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 të Ligjit Nr.03/L-40 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), si dhe në pajtim me nenin 81 të Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurim Publik në Republikën e Kosovës, Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik / Nr.A01, në bashkëpunim me dhe propozim të Përgjegjësit të Njesisë Kërkuese dhe Drejtorit të Drejtorisë për Prokurim Publik, më dt. 29.06.2026 merr:

V E N D I M

- I. Emërimin e Menaxherit të Kontratës
- II. Emërimin e Mbikëqyrësit të Drejtpërdrejt të Menaxherit të Kontratës

Furnizim me Makineri bujqësore(Traktor) -participim me fermerë me numër të prokurimit: 635-26-1742-1-1-1 numri i brendshëm i prokurimit: 635-26-021-111 dhe Numri i kontratës: 635-26-1742-1-1-1/C1308

- i. Menaxher i Kontratës caktohet: **BURIM KELMENDI** Inspektor i ndertimit
- ii. Mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës caktohet: **TAHIR SHALA** Drejtorë ne Drejtoratin e Bujqesis

Përgjegjësitë dhe funksionet e [Menaxherit të Kontratës], janë që të :

- a) Në pajtim me nenin 61.7 të rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik, pas pranimi të Njoftimit për emërim si menaxher i kontratës, menaxheri i Kontratës duhet të kyçet në Sistemin e Prokurimit Elektronik dhe duhet të filloi me fazat e menaxhimit të Kontratës nëpërmjet funksioneve për menaxhim të kontratës. Si fazë e parë Menaxheri i kontratës brenda afatit duhet të krijoj Planin për Menaxhim të kontratës duke përdorur funksionin "Fillimi / mobilizimi i kontratës;
- b) Menaxhojë obligimet dhe detyrat e Autoritetit Kontraktues të specifikuar në Kontratë;
- c) Sigurojë që Operatori Ekonomik përmbushë të gjitha obligimet e performances apo dërgesës në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- d) Sigurojë që Operatori Ekonomik dorëzon tërë dokumentacionin e kërkuar në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- e) Sigurojë që Komuna i përmbushë gjitha pagesat dhe obligimet tjera në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- f) Sigurojë se ka kontroll adekuate të kostove, cilësisë dhe kohës;
- g) Sigurojë që të gjitha obligimet janë kompletuar para mbylljes së dosjes së Kontratës;
- h) Sigurojë që të gjitha regjistrat e menaxhimit të kontratës të mbahen dhe arkivohen në modulën për menaxhim të kontratës në sistem të prokurimit elektronik;
- i) Bëj vlerësimin e performances se operatorit ekonomik në sistem të prokurimit elektronik pas përfundimit të kontratës
- j) Nxjerrë variacione apo urdhra për ndryshim nëse kërkohet, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës dhe legjislacionin për natyrën e aktivitetit ;

- k) Sigurojë detaje të plota të një ndryshimi të kërkuar të kontratës Departamentit të Prokurimit dhe ta merr miratimin;
- l) Të menaxhojë dorëzimin e procedurave të pranimit;
- m) Jep detaje të plota për ndonjë ndërprerje të propozuar të kontratës Departamentit të Prokurimit;
- n) Dorëzoj raporte mbi progresin ose kompletimin e një kontratë, siç kërkohet nga Departamenti i Prokurimit ose nga Zyrtari Kryesor administrativ.

Përgjegjësitë dhe funksionet e Mbikëqyrësit të Drejtpërdrejt të Menaxherit të Kontratës, janë:

- a) mbikëqyrja e drejtpërdrejtë e implementimit të kontratës;
- b) administrimi i plotë i kontratës, përfshirë çfarëdo ndryshimi eventual të kontratës, dhe
- c) rishikimi, aprovimi dhe procesimi i vlerësimit të performances se operatorit ekonomik të propozuar nga menaxheri i kontratës.

3. Vendimi hyn në fuqi dhe zbatohet ditën e marrjes.

Kopje: Menaxheri i Kontratës;
[Ekipit për menaxhim të kontratës]
[Mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i Menaxherit të Kontratës];
 Drejtorisë së Prokurimit;
 Drejtorit të Njesisë Kërkuese


Zyrtari Kryesor Administrativ
Gazmend Muhaxheri





KUVENDI KOMUNAL PEJË

Nr., date: 31 Korrik 2026

Në bazë të nenit 11. dhe Nenit 12.paragrafi 1. të Ligjit Nr.03/L – 040 Për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28.datë: 04.qershor 2008”), dhe nenit 20 paragrafi 1 pika 1.4 të Statutit Nr. 01/2020 të Komunës së Pejës, I.Numër: 01-016/01-413431 dt. 30. Shtator 2020, Kuvendi Komunal Pejë, në takimin e mbajtur me datë: 31 Korrik 2026, në propozim të kryesuesit të Kuvendit, merr këtë:

Draft - VENDIM

Nr. --/2026

mbi formimin e Komisionit për hartimin e planit të punës së Kuvendit Komunes së Pejës, për vitin 2027

1. Formohet Komisioni për hartimin e planit të punës së Kuvendit të Komunës së Pejës, për vitin 2027, në përbërje:

- 1.1. Rexhep Kurtrbogaj, kryesues i Kuvendit të Komunës, kryesues,
- 1.2. , nga subjekti politikë LDK, anëtarë/re,
- 1.3. , -/- AAK, anëtarë/re,
- 1.4. , -/- LVV, anëtarë/re,
- 1.5. , -/- PDK, anëtarë/re,
- 1.6. , komunitete BSK, anëtarë/re, dhe
- 1.7. Avni Gashi, nga Sekretaria e Kuvendit të Komunës, anëtarë/re.

2. Detyrë e Komisionit nga pika 1 e këtij vendimi është hartimi i Planit e punës së Kuvendit të Komunës së Pejës, për vitin 2027 dhe të procedoi atë në shqyrtim dhe miratim në KPF-ca dhe Kuvendin e Komunës.

3. Për zbatimin këtij Vendimi do të kujdeset Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Pejës.

4. Ky vendim hynë në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhë zyrtare në Web-faqen e Komunës së Pejës.

KRYESUESI I KUVENDIT
z. Rexhep Kurtbogaj

Vendimi ti dërgohet:

- 1x1. Kryetarit të Komunës
- 1x1. Anëtarëve të komisionit
- 1x1. Arkivë.



Komuna e Pejës
Municipality of Peja
Opština Peć

Raporti Gjashtëmujor

Janar-Qershor 2026

KORRIK, 2026



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ



Data / Date / Datum:	08.07.2026
Për / To / Za:	Zyrës së Kryetarit
Nga / From / Od:	Nita Panduri Mullarama - Drejtoria për Administratë
Lënda / Subject / Tema:	Raport i punës: 05 janar - 30 qershor 2026

R A P O R T I P U N Ë S

Në këtë drejtori veprojnë 7 sektorë:

1. Gjendja Civile
2. Qendra për Shërbim të Qytetarëve
3. Ligjor
4. Përkthim dhe lekturim
5. Teknologji informative
6. Logjistikë
7. Barazi gjinore

Të gjitha lëndët e Drejtorisë për Administratë, për periudhën e raportimit, janë shqyrtuar brenda afateve të parashikuara. Lëndë të papërfunduara janë 0 (zero). Lëndët janë përfunduar me kohë, me zgjidhje në afate rekorde dhe me përgjigje të shpejtë për palët. Totali i lëndëve në nivel komunal është 45.044, ndërsa vetëm nga Drejtoria për Administratë janë trajtuar 32.817 lëndë, që përbëjnë 72.85% të totalit.

Nga Drejtoria për Administratë janë realizuar këto punë dhe projekte:

1. Furnizim me pajisje të Teknologjisë Informative
2. Furnizim me kompjuterë
3. Mirëmbajtja e kamerave të qytetit
4. Furnizim me material administrativ për nevojat e SHCK-së
5. Furnizim me material elektrik për SHCK
6. Furnizim me artikuj për mirëmbajtjen e objekteve
7. Servisimi (Mirëmbajtja) e automjeteve
8. Sigurimi dhe regjistrimi i automjeteve
9. Furnizim me naftë për ngrohje
10. Furnizim me naftë për veturat zyrtare
11. Takime dhe aktivitete për fëmijët dhe të drejtat e tyre
12. Mbështetje e ekipeve sportive të qytetit me transport, si dhe e shoqërive artistike, kryesisht për kërkesa që lidhen me DKRS-në.

Vendosja e të dhënave sipas raporteve nga sektorët:

Bazuar në raportet e dërguara nga udhëheqësit e sektorëve në Drejtorinë e Administratës, raporti i punës për periudhën 05 janar - 30 qershor 2026 është si vijon:

1. SHËRBIMI I GJENDJES CIVILE

Ka kryer këto shërbime:

1. Vendime për regjistrim me vonesë në RTHL	- 6
2. Vendime për regjistrim me vonesë në RTHV	- 38
3. Vendime për korrigjime të emrit/mbiemrit	- 58
4. Vendime për ndërrim të emrit/mbiemrit	- 50
5. Regjistrime në RTHL	- 988
6. Regjistrime në RTHV	- 424
7. Regjistrime në RTHM	- 402
8. Certifikata të lindjes të lëshuara	- 8.566
9. Ekstrakte të lindjes të lëshuara	- 20.478
10. Certifikata të kurorëzimit të lëshuara	- 5.107
11. Certifikata të vdekjes të lëshuara	- 2.853
12. Certifikata të statusit martesor të lëshuara	- 912
13. Certifikata të vendbanimit të lëshuara	- 3.172
14. Certifikata të shtetësisë të lëshuara	- 224
15. Deklarata të Bashkësisë Familjare të lëshuara	- 2.538
16. Vërtetime nga Arkiva të lëshuara	- 746
17. Raporte të statistikës për lindje DEM-1	- 988
18. Raporte të statistikës për vdekje DEM-2	- 424
19. Raporte të statistikës për kurorëzime DEM-3	- 402
20. Aplikime për t'u liruar nga shtetësia e Kosovës	- 11
21. Aplikime për ta fituar shtetësinë e Kosovës	- 86
22. Aplikime për të rikthyer shtetësinë e Kosovës	- 87

Gjithsej shërbime të kryera: 46.746

Janë realizuar taksa nga zyrtarët: 57.341,00 euro.

Vërejtje: Në raport janë të përfshira shërbimet nga data 05.01.2026 deri më 30.06.2026.

2. QENDRA PËR SHËRBIM TË QYTETARËVE

- Qendra për Shërbim të Qytetarëve, gjatë periudhës janar-qershor 2026, ka ndërmarrë një sërë aktivitete të ndryshme në kuadër të Drejtorisë për Administratë, si dhe në bashkëpunim me institucionet e tjera relevante që ndërlidhen me këtë sektor.
- Qendra për Shërbim të Qytetarëve, gjatë periudhës janar-qershor 2026, ka pranuar kërkesa, ankesa dhe dokumente të tjera të parashtruara dhe të destinuara në drejtori të ndryshme, sipas tabelës së mëposhtme:

Kjo qendër, së bashku me Gjendjen Civile, ka pranuar gjithsej 45.044 kërkesa, ankesa dhe dokumente të tjera të parashtruara dhe të destinuara në drejtori të ndryshme, sipas tabelës së mëposhtme:

Raporti sipas departamenteve dhe statusit të zgjidhjes

05/01/2026 - 30/06/2026

Përshkrimi	Pranuar	Në proces	Miratuar	Refuzuar	Hedhur poshtë	Pezulluar	Ceduar	Anuluar	Përfunduar	Totali
Drejtoria për Administratë	10	23	3,718	25	1	3	0	5	29,032	32,817
Drejtoria për Arsim	3	100	2,001	2	0	0	0	75	0	2,181
Kuvendi Komunal	0	23	38	0	0	0	0	0	0	61
Drejtoria për Buxhet dhe Financa	5	198	698	1	0	0	0	0	0	902
Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport	0	145	23	7	0	3	0	1	0	179
Drejtoria për Mirëqenie Sociale	0	91	15	0	0	15	1	0	0	122
Drejtoria për Shëndetësi	0	516	35	1	0	0	0	1	0	553
Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit	0	133	470	216	0	52	0	9	0	880
Kryetari i Komunës	1	634	308	14	0	38	5	26	0	1,026
Drejtoria për Zhvillim Ekonomik	0	143	0	0	0	0	0	0	0	143
Drejtoria për Kadastër dhe Gjeodezi	44	352	2,851	0	0	0	0	19	0	3,266
Drejtoria për Punë Komunale dhe Shërbime Publike	0	94	249	50	0	0	0	0	0	393
Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtimit	0	91	0	0	0	0	0	0	0	91
Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi	0	277	209	611	6	0	0	4	0	1,107
Drejtoria për Punë Inspektuese	0	190	0	0	0	0	0	0	0	190
Drejtoria për Çështje Pronësoro-Juridike	1	279	713	3	0	0	0	18	0	1,014
Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim	0	0	4	1	0	0	0	0	0	5
Prokurimi	1	103	8	2	0	0	0	0	0	114
Gjithsej	65	3,392	11,340	933	7	111	6	158	29,032	45,044

Në Qendrën për Shërbim të Qytetarëve kanë kaluar lëndë nga të gjitha drejtoritë; lëndët nga Drejtoria për Administratë janë aprovuar nga zyrtarët e Drejtorisë për Administratë.

3. ZYRA LIGJORE KOMUNALE

Gjatë periudhës gjashtëmujore, konkretisht 05 janar - 30 qershor 2026, Zyra Ligjore ka kryer këto aktivitete, të cilat po i paraqesim si në vijim:

1. Pjesëmarrja në punëtori të ndryshme në 2 raste.
2. Hartimi dhe përpilimi i marrëveshjeve në 1 rast.
3. Interpretime dhe konsultime ligjore në 3 raste.

Për raport më të detajuar është bashkëngjitur aneksi.

4. PËRKTHIM DHE LEKTURIM

Zyra e përkthimeve ka kryer punën e vet në harmoni me Ligjin për përdorimin e Gjuhëve Zyrtare në Kosovë.

Të gjitha dokumentet që kanë ardhur për përkthim në këtë zyrë janë përkthyer, në afat, me kohë dhe pa ndonjë vonesë (dokumente dhe materiale të ndryshme nga të gjitha drejtoritë dhe zyrët, komitetet dhe organet tjera të komunës).

Prej muajit janar deri në qershor të vitit 2026 janë përkthyer gjithsej 335 faqe materialesh të ndryshme, si dhe 13 orë përkthime të drejtpërdrejta në takime të ndryshme. Më poshtë paraqitet një pasqyrë e dokumenteve kryesore dhe të vazhdueshme që janë përkthyer:

1. Procesverbalet e Kuvendit të Komunës;
2. Procesverbalet e Komitetit për Politikë dhe Financa;
3. Procesverbalet e Komitetit për Komunitete;
4. Procesverbalet e KKS-së;
5. Vërtetime të ndryshme;
6. Vendime dhe Aktvendime të ndryshme;
7. Konkurse të ndryshme, konkluzione, njoftime, ftesa;
8. Njoftime të ndryshme, plane dhe strategji;
9. Projekte të ndryshme.

5. TEKNOLOGJI INFORMATIVE

Gjatë periudhës raportuese janë kryer punë të përditshme dhe është raportuar për çdo ditë pune. Numri i kërkesave të realizuara është 722.

Bazuar në kërkesat e tjera për menaxhim dhe implementim, më poshtë paraqiten aktivitetet kryesore të realizuara:

- Planifikimi për riparimin e rrjetit dhe përgatitja e kërkesës drejtuar drejtorisë për përfshirje në planin e prokurimit.
- Kontributi i dhënë nga Sektori për Teknologji Informative në përgatitjet për shërbimet e platformës e-Kosova, në pjesën që përfshin të dhënat e kërkuara nga Komuna e Pejës.
- Menaxhimi i bazës së të dhënave Menaxhimi i lëndëve të brendshme Financiare nga Sektori për Teknologji Informative.
- Pjesëmarrja e zyrtarëve të Sektorit për Teknologji Informative në komisione, takime të ndryshme, punëtori dhe konsulta.
- Menaxhimi i kontratave nga zyrtarët e sektorit.
- Mbështetja e shërbimit të Kuvendit Komunal me votim elektronik dhe shërbime të tjera teknike.
- Përgatitja e paramasave për punë të ndryshme nga Sektori për Teknologji Informative.
- Menaxhimi i bazave lokale të të dhënave të krijuara me zero kosto.
- Menaxhimi i bazave të të dhënave nga ASHL.
- Furnizimi dhe montimi i pajisjeve për Teknologji Informative, përfshirë kompjuterët dhe pajisjet përcjellëse.

Për një raport më të detajuar, aneksi i veçantë i dorëzohet Drejtoreshës së Drejtorisë.

6. LOGJISTIKA

Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2026, Sektori i Logjistikës ka zhvilluar aktivitete të vazhdueshme në mbështetje të funksionimit të rregullt të administratës komunale, mirëmbajtjes së objekteve komunale, përkrahjes teknike të drejtorive, menaxhimit të mjeteve të punës, furnizimeve dhe intervenimeve të ndryshme operative në terren.

Puna e Sektorit të Logjistikës ka pasur rol të rëndësishëm në sigurimin e kushteve të përshtatshme për punë, mirëmbajtjen e hapësirave komunale, funksionalizimin e pajisjeve, transportin, bartjen dhe sistemimin e inventarit, mbikëqyrjen e shërbimeve të pastrimit, si dhe kryerjen e detyrave të përditshme sipas kërkesave të Drejtorisë së Administratës, drejtorive të tjera dhe njësive komunale.

Aktivitetet kryesore të realizuara gjatë vitit 2026 janë:

- Mirëmbajtja e rregullt e objekteve komunale, përfshirë ndërtesën e administratës, kuvendit, kadastrës dhe hapësirat e tjera në përdorim të komunës.
- Furnizimi i objekteve dhe drejtorive me material të pastrimit, material higjienik dhe mjete të tjera të nevojshme për mirëmbajtje.
- Mirëmbajtja dhe servisimi i veturave zyrtare, duke përfshirë kontrollin teknik, riparimet, ndërrimin e pjesëve të nevojshme dhe përgatitjen e dokumentacionit për përdorim të rregullt.
- Regjistrimi i automjeteve zyrtare, përfshirë edhe regjistrimin e pesë veturave të reja të pranura gjatë vitit.
- Organizimi dhe koordinimi i përdorimit të automjeteve zyrtare sipas nevojave të drejtorive dhe zyrtarëve komunalë.
- Rregullimi dhe montimi i paneleve ndriçuese në zyra, korridore dhe hapësira të ndryshme të ndërtesave komunale.
- Intervenime në defekte të ndryshme në hapësirat sanitare, instalimet e ujësjellësit dhe pajisjet sanitare.
- Furnizimi me material shpenzues për nevojat e të gjitha drejtorive komunale.
- Pranimi, evidentimi dhe shpërndarja e mallit të furnizuar për drejtoritë dhe njësitë përkatëse.
- Vendosja dhe evidentimi i materialeve hyrëse dhe dalëse në sistemin e pasurisë, me qëllim të përcjelljes së saktë të furnizimeve, shpërndarjes dhe gjendjes së materialeve.
- Përgatitja e lëndëve për pagesë nga Drejtoria e Administratës dhe kompletimi i dokumentacionit përcjellës.
- Përgatitja dhe procedimi i pagesave për shërbime komunale, përfshirë obligimet që lidhen me funksionimin e objekteve komunale dhe nevojat operative të administratës.
- Kryerja e detyrave si zyrtarë alternativë për pagesa dhe pranime të mallit për drejtoritë komunale.
- Lëvizja, vendosja dhe riorganizimi i inventarit sipas kërkesave të zyrave dhe drejtorive.
- Përkrahje logjistike në organizimin e takimeve, aktiviteteve institucionale dhe nevojave të brendshme të administratës.
- Sigurimi i materialeve bazike për zyra, pajisjeve ndihmëse dhe materialeve të tjera të nevojshme për funksionimin e përditshëm.
- Mbështetje në pastrimin dhe rregullimin e hapësirave publike apo objekteve sipas kërkesave të paraqitura.
- Koordinimi me operatorët ekonomikë për shërbime të mirëmbajtjes, servisimit, furnizimit dhe intervenimeve teknike.
- Përcjellja e gjendjes së objekteve dhe raportimi i nevojave për intervenime, riparime apo furnizime shtesë.
- Kryerja e punëve të përditshme operative që paraqiten si kërkesë nga Drejtoria e Administratës dhe njësitë e tjera komunale.

Gjatë vitit 2026, Sektori i Logjistikës ka qenë vazhdimisht i angazhuar në ofrimin e mbështetjes praktike, teknike dhe administrative për të gjitha drejtoritë komunale. Përmes mirëmbajtjes, furnizimit, transportit, evidentimit të materialeve në sistem, përgatitjes së dokumentacionit për pagesa, intervenimeve në objekte dhe koordinimit të shërbimeve, është synuar që administrata komunale të funksionojë pa pengesa dhe në kushte sa më të mira pune.

Në përfundim, puna e Sektorit të Logjistikës gjatë gjashtëmuajorit të parë të vitit 2026 ka kontribuar drejtpërdrejt në rritjen e efikasitetit të punës së administratës, ruajtjen dhe evidentimin më të mirë të pasurisë komunale, përmirësimin e kushteve të punës dhe mbështetjen e vazhdueshme për realizimin e detyrave të përditshme institucionale.

Raporti më i detajuar me vlera është paraqitur në aneks të veçantë.

7. BARAZI GJINORE

Ky raport përmbledh aktivitetet kryesore të realizuara gjatë periudhës janar–qershor 2026 nga Zyra për Mbrojtjen e Fëmijës dhe Sekretariati i Ekipit për të Drejtat e Fëmijës në Komunën e Pejës. Aktivitetet janë zhvilluar në kuadër të monitorimit dhe zbatimit të Planit të Punës 2024–2026, si dhe në funksion të avancimit të standardeve të Komunës Mike për Fëmijët.

Gjatë kësaj periudhe është vërejtur përparim në forcimin e mekanizmave lokalë për mbrojtjen e fëmijëve, në rritjen e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe në përfshirjen më aktive të fëmijëve në proceset vendimmarrëse. Përmes aktiviteteve të realizuara është synuar promovimi i të drejtave të fëmijëve, mbrojtja e mirëqenies së tyre dhe krijimi i hapësirave ku zëri i tyre dëgjohet dhe merret parasysh.

Në kuadër të obligimeve raportuese, Zyra për Mbrojtjen e Fëmijës ka ofruar të dhëna për Zyrën për Integrim lidhur me përmbushjen e obligimeve të Agjendës Evropiane për periudhat raportuese janar–dhjetor 2025 dhe janar–qershor 2026, me theks të veçantë në zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës. Po ashtu, gjatë kësaj periudhe janë ndjekur aktivitete dhe trajnime që lidhen me fuqizimin e grave, shërbimet sociale me bazë në komunitet, buxhetimin e ndjeshëm ndaj fëmijëve dhe mbrojtjen e të drejtave të tyre.

Një zhvillim i rëndësishëm ka qenë mbajtja e mbledhjes konstituive të Ekipit për të Drejtat e Fëmijës më 16 mars 2026, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve institucionalë dhe akterëve relevantë. Ekipi është themeluar në përputhje me Ligjin Nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës dhe Udhëzimin Administrativ (QRK) Nr. 06/2022. Në këtë takim u theksua rëndësia e bashkëpunimit të vazhdueshëm ndërmjet institucioneve për zbatimin e politikave dhe aktiviteteve që ndikojnë drejtpërdrejt në përmirësimin e mirëqenies dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.

Gjatë muajve shkurt dhe qershor janë realizuar aktivitete të rëndësishme me Asamblenë Komunale të Fëmijëve, duke përfshirë seancën e rregullt të AKF-së, hapjen e Kutisë së Ankesave “Të Drejtat e Fëmijëve”, si dhe Seancën Konstituive të AKF-së për mandatin 2026–2028, e mbajtur më 1 qershor 2026, me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve. Në këtë aktivitet u bë dorëzim-pranimi i mandatit nga kryetari i deritanishëm tek kryetarja e re e Asamblesë, si dhe u ndanë mirënjohje për anëtarët dhe bashkëpunëtorët.

Gjatë periudhës prill–maj 2026 është realizuar procesi zgjedhor për Asamblenë Komunale të Fëmijëve në 26 shkolla fillore dhe të mesme të ulëta të komunës së Pejës. Në këtë proces morën pjesë gjithsej 547 nxënës, prej tyre 341 vajza dhe 206 djem. Nga 164 kandidatë të propozuar, u zgjodhën 33 anëtarë të

Asamblesë Komunale të Fëmijëve. Procesi ka siguruar përfaqësim të komuniteteve joshumicë, si dhe vende të veçanta për fëmijët me nevoja të veçanta dhe fëmijët me diabet.

Në kuadër të ngritjes së kapaciteteve, janë mbajtur punëtori dhe trajnime për buxhetimin e ndjeshëm ndaj fëmijëve, avokimin dhe përfshirjen e tyre në vendimmarrje. Këto aktivitete janë organizuar nga Syri i Vizionit dhe Save the Children Kosova/o, me qëllim të fuqizimit të rolit të fëmijëve në proceset lokale. Gjithashtu, më 26 maj 2026, përfaqësuesja e Zyrës për Mbrojtjen e Fëmijës është emëruar anëtare e Grupit Punues për Planifikimin e Buxhetit 2027–2029.

Në përfundim, aktivitetet e realizuara gjatë kësaj periudhe dëshmojnë angazhimin e Komunës së Pejës për forcimin e mbrojtjes së fëmijëve, përmirësimin e koordinimit institucional dhe krijimin e mundësive konkrete që fëmijët të jenë pjesë aktive e proceseve që ndikojnë në jetën dhe mirëqenien e tyre.

Raporti i detajuar gjendet në aneksin e dorëzuar te drejtoresha e drejtorisë.

Drejtoreshë e Drejtorisë për Administratë

Nita Panduri Mullarama



DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA

DIREKTORAT ZA BUDŽET I FINANSIJE / DEPARTMENT OF BUDGET AND FINANCE

RAPORT GJASHTËMUJOR MBI REALIZIMIN E AKTIVITETEVE TË DREJTORISË PËR BUXHET DHE FINANCA

Periudha: Janar - Qershor 2026

Drejtoria për Buxhet dhe Financa, në përputhje me kompetencat e saj ligjore dhe përgjegjësitë institucionale, gjatë periudhës **janar-qershor 2026** ka zhvilluar aktivitetet e planifikuara me qëllim të sigurimit të një menaxhimi të qëndrueshëm financiar, administrimit efikas të buxhetit komunal, monitorimit të realizimit të të hyrave dhe shpenzimeve, si dhe përmbushjes së obligimeve ligjore ndaj institucioneve qendrore.

Gjatë kësaj periudhe është punuar në përmbylljen e proceseve financiare të vitit paraprak, hartimin e raporteve financiare, përgatitjen e Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB), analizën e të hyrave dhe shpenzimeve, si dhe në realizimin e aktiviteteve të përditshme që lidhen me menaxhimin e buxhetit komunal.

Aktivitetet janë zhvilluar në bashkëpunim të vazhdueshëm me drejtoritë komunale, Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, Thesarin e Kosovës dhe institucionet e tjera përgjegjëse, duke garantuar respektimin e afateve ligjore dhe procedurave financiare.

AKTIVITETET NË FUSHËN E FINANCAVE

Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2026, sektori i financave ka realizuar një sërë aktivitesh me rëndësi për funksionimin e administrimit financiar të Komunës së Pejës. Në fillim të vitit është përfunduar procesi i mbylljes së vitit fiskal 2025, duke përfshirë analizën e të hyrave të realizuara, harmonizimin e të dhënave financiare dhe përgatitjen e informatave për drejtoritë komunale lidhur me nivelin e arkëtimit dhe planifikimin financiar.

Një aktivitet me rëndësi të veçantë ka qenë **bartja e mjeteve financiare nga viti paraprak**, proces i cili është përmbyllur me sukses gjatë muajit qershor, duke siguruar vazhdimësinë e financimit të projekteve dhe aktiviteteve komunale.

Po ashtu është përgatitur analiza financiare për tremujorin e parë të vitit 2026 dhe është koordinuar procesi i auditimit të jashtëm, në përputhje me kërkesat ligjore dhe standardet e menaxhimit financiar.

Gjatë gjithë periudhës raportuese janë realizuar në vazhdimësi aktivitetet operative, duke përfshirë:

- përditësimin e planit të rrjedhës së parasë në Thesar;
- publikimin e raporteve mujore financiare;
- zotimin e mjeteve buxhetore sipas kërkesave të drejtorive;
- procesimin e pagesave për të gjitha kategoritë ekonomike;
- analizën financiare të projekteve kapitale;
- përgatitjen e zotimeve sipas planit të prokurimit publik;
- alokimin e të hyrave vetanake në përputhje me planifikimin buxhetor.

Këto aktivitete kanë siguruar funksionimin e rregullt të sistemit financiar komunal dhe menaxhimin efikas të mjeteve publike.

AKTIVITETET NË FUSHËN E BUXHETIT

Në fushën e planifikimit dhe menaxhimit buxhetor, Drejtoria për Buxhet dhe Financa ka përmbyllur të gjitha obligimet ligjore të parapara për periudhën raportuese.

Është përgatitur dhe finalizuar Raporti i të Hyrave dhe Shpenzimeve për vitin 2025, si dhe janë hartuar pasqyrat financiare vjetore në afatet e përcaktuara.

Gjithashtu është përgatitur raporti financiar për tremujorin e parë të vitit 2026, duke ofruar një pasqyrë të realizimit të buxhetit dhe nivelit të ekzekutimit të shpenzimeve.

Një nga aktivitetet më të rëndësishme gjatë kësaj periudhe ka qenë **hartimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB) 2027-2029**, proces i cili është realizuar në bashkëpunim me të gjitha drejtoritë komunale dhe është përmbyllur brenda afateve ligjore.

Në kuadër të këtij procesi është organizuar edhe dëgjimi publik për KAB-in, me pjesëmarrjen e qytetarëve dhe palëve të interesit, duke kontribuar në rritjen e transparencës dhe përfshirjes së publikut në procesin e planifikimit buxhetor.

Paralelisht, gjatë gjithë gjashtëmujorit është realizuar protokollimi dhe barazimi i faturave me Departamentin e Financave, duke siguruar saktësinë dhe integritetin e evidencave financiare.

AKTIVITETET NË FUSHËN E TATIMIT NË PRONË

Gjatë periudhës raportuese është realizuar analiza e të hyrave nga Tatimi në Pronë për vitin paraprak, me qëllim të vlerësimit të performancës në arkëtim dhe identifikimit të masave për përmirësimin e mëtejshëm të këtij procesi.

Procesi i shpërndarjes së faturave të Tatimit në Pronë për vitin 2026 nuk ka filluar gjatë gjashtëmujorit të parë, për shkak të vonesave në funksionalizimin e sistemit për administrimin e tatimit në pronë. Si rrjedhojë, nuk ka qenë e mundur të përcaktohet një afat i saktë për fillimin e shpërndarjes së tyre.

Pavarësisht kësaj, sektori ka vazhduar pa ndërprerje aktivitetet e rregullta, duke përfshirë pranimin dhe shqyrtimin e ankesave të tatimpaguesve, regjistrimin e objekteve të reja, rianketimin e pronave, lëshimin e vërtetimeve, printimin e faturave sipas kërkesave të qytetarëve dhe ofrimin e shërbimeve për pagesën e taksës rrugore.

Këto aktivitete kanë siguruar vazhdimësinë e ofrimit të shërbimeve administrative për qytetarët dhe mirëmbajtjen e evidencave të tatimit në pronë.

-Gjatë periudhës **janar-qershor 2026**, Drejtoria për Buxhet dhe Financa ka realizuar me sukses pjesën dërrmuese të aktiviteteve të planifikuara, duke përmbushur obligimet ligjore dhe institucionale në fushën e menaxhimit financiar dhe buxhetor.

Proceset kryesore, si përmbyllja e vitit fiskal, përgatitja e raporteve financiare, hartimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore, koordinimi i auditimit të jashtëm dhe administrimi i përditshëm i buxhetit, janë realizuar në përputhje me afatet dhe procedurat në fuqi. Përkundër sfidave të evidentuara në funksionalizimin e sistemit të administrimit të Tatimit në Pronë, Drejtoria ka vazhduar ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve dhe ka ndërmarrë të gjitha veprimet që kanë qenë në kompetencën e saj për të siguruar funksionimin normal të proceseve financiare.

Në përgjithësi, performanca e Drejtorisë për Buxhet dhe Financa gjatë gjashtëmuorit të parë të vitit 2026 vlerësohet e suksesshme, duke reflektuar angazhim institucional, menaxhim të përgjegjshëm të financave publike dhe përkushtim në përmbushjen e objektivave të përcaktuara.

Për të plotësuar pasqyrën e performancës financiare të Drejtorisë për Buxhet dhe Financa gjatë periudhës raportuese, në vijim paraqiten tabelat me të dhënat e detajuara mbi realizimin e të hyrave vetanake dhe shpenzimeve buxhetore për periudhën Janar-Qershor 2026.

Të hyrat vetanake të realizuara gjatë periudhës Janar-Qershor 2026

Përshkrim	Kredi
16319 - ADMINISTRATA	60,611.70
50013 - TAKSA PËR CERTIFIKATË TË LINDJES	1,042.00
50014 - TAKSA PËR CERTIFIKATË TË KURORËZIMIT	4,380.00
50015 - TAKSA PËR CERTIFIKATË TË VDEKJES	1,859.00
50016 - TAKSA PËR CERTIFIKATA TË TJERA	45,188.00
50017 - TAKSA PËR VERIFIKIMIN E DOKUMENTEVE TË NDRYSHME	5,735.00
50018 - TAKSA E FOTOKOPJIMIT TË DOKUMENTEVE	2,400.70
50019 - TAKSA TË TJERA ADMINISTRATIVE	7.00
16637 - INSPEKSIONI	1,425.00
50104 - GJOBAT NGA INSPEKTORATI	1,050.00
50205 - LICENCA PËR PRANIM TEKNIK TË LOKALEVE	375.00
17519 - BUXHETI - PEJË	1,211,608.01
40110 - TATIMI NË PRONË	1,058,753.01
50001 - TAKSA PËR REGJISTRIM TË AUTOMJETEVE	152,855.00
18019 - SHËRBIME PUBLIKE - INFRASTRUKTURA RRUGORE	34,441.47
50008 - TAKSA PËR PARKIM PUBLIK, KAMPING DHE REKREACION	15,140.00
50212 - LICENCA PËR REKLAMA DHE PUBLIKIME NË PRONA PUBLIKE	19,295.57
61000- TE HYRAT NGA VITI I KALUAR	5.90
47019 - BUJQËSIA - PEJË	141,641.80
50012 - TAKSA PËR NDËRRIM TË DESTINIMIT TË PRONËS	139,715.19
50405 - SHFRYTËZIMI I PRONËS PUBLIKE	1,926.61
48019 - PLANIFIKIMI DHE ZHVILLIMI EKONOMIK	6,250.00
50206 - LICENCA PËR MARKA TREGTARE DHE PATENTIM	3,400.00
50211 - LICENCA PËR SHËRBIM DHE PRODHIM TË PIJEVE ALKOOLIKE	2,850.00
65095 - SHËRBIMET KADASTRALE	88,571.00
50011 - TAKSA PËR NDËRRIM TË PRONARIT TË PRONËS	40,395.00
50019 - TAKSA TË TJERA ADMINISTRATIVE	1,087.00
50032 - TAKSA PËR CERTIFIKATË TË PRONËSISË DHE KOPJE PLANI	19,848.00
50460 - TAKSA PËR REGJISTRIM TË PENGUT	3,645.00
50504 - MATJA E TOKËS NË TERREN	23,596.00


65495 - ÇËSHTJET LIGJORE	260,278.75
50212 - LICENCA PËR REKLAMA DHE PUBLIKIME NË PRONA PUBLIKE	103,383.25
50405 - SHFRYTËZIMI I PRONËS PUBLIKE	145,153.00
50408 - QIRAJA NGA PRONA PUBLIKE	11,042.50
50413 - SHITJA E PASURISË PUBLIKE	700.00
66100 - PLANIFIKIMI HAPËSINOR DHE RREGULLATIV	888,006.92
50009 - TAKSA PËR LEJE NDËRTIMI	874,362.02
50026 - TAKSA PËR LEGALIZIMIN E OBJEKTEVE	13,644.90
74100 - SHËRBIMET E KUJDESIT PRIMAR SHËNDETËSOR	48,383.00
50409 - PARTICIPIMET	48,383.00
85019 - SHËRBIMET KULTURORE	771.00
50409 - PARTICIPIMET	771.00
92570 - ARSIMI PARAFILLOR ÇERDHET	109,425.00
50409 - PARTICIPIMET	109,425.00
94741 - SHKOLLA E MESME TEKNIKE SH.SPAHIA	33,735.00
50409 - PARTICIPIMET	33,735.00
94744 - SHKOLLA E MESME EKONOMIKE - ALI HADRI	19,800.00
50409 - PARTICIPIMET	19,800.00
49 - BE - BASHKIMI EUROPIAN	46,382.31
48019 - PLANIFIKIMI DHE ZHVILLIMI EKONOMIK	46,382.31
56000 - TË HYRAT NGA GRANTET E PËRCAKTUARA	46,382.31
Bilanci i përgjithshëm	2,951,330.96

Shpenzimet e realizuara gjatë periudhës Janar-Qershor 2026

Përshkrimi	Buxheti 2026	Aktual	%
11 PAGA DHE SHITESA	21,325,746.60	12,263,108.63	57.50
16019 ZYRA E KRYETARIT	243,739.66	118,037.88	48.43
16319 ADMINISTRATA	508,045.25	258,355.20	50.85
16519 ÇËSHTJE GJINORE	19,476.87	5,187.11	26.63
16559 INTEGRIMET EVROPIANE	12,221.13	7,264.93	59.45
16637 INSPEKSIONI	285,325.91	153,595.64	53.83
16795 PROKURIMI	40,282.94	23,399.85	58.09
16919 ZYRA E KUVENDIT KOMUNAL	411,993.20	176,718.03	42.89
17519 BUXHETI	323,796.72	159,894.84	49.38
18019 SHËRBIME PUBLIKE - INFRASTRUKTURA RRUGORE	162,459.08	84,808.25	52.20
18295 SHËRBIMET E ZJARRFIKËSVE	442,428.00	220,150.98	49.76
19595 ZYRA LOKALE E KOMUNITETEVE	76,787.62	32,204.18	41.94
47019 BUJQËSIA	192,409.64	106,628.59	55.42
48019 PLANIFIKIMI DHE ZHVILLIMI EKONOMIK	67,271.17	36,705.58	54.56
65095 SHËRBIMET KADASTRALE	182,445.13	95,486.32	52.34
65495 ÇËSHTJET LIGJORE	52,278.40	28,824.49	55.14
66100 PLANIFIKIMI HAPËSINOR DHE RREGULLATIV	128,446.16	65,930.20	51.33
73028 ADMINISTRATA	40,612.04	19,393.88	47.75
74100 SHËRBIMET E KUJDESIT PRIMAR SHËNDETËSOR	4,068,739.71	2,263,708.26	55.64
75591 SHËRBIMET SOCIALE	187,900.62	93,867.52	49.96
75592 SHERBIM.REZIDENCIALE	52,500.00	0.00	0.00
85019 SHËRBIMET KULTURORE	313,134.17	174,402.35	55.70
85184 TEATRI	195,021.19	97,438.86	49.96
92095 ADMINISTRATA	153,174.89	81,721.59	53.35
92570 ARSIMI PARAFILLOR ÇERDHET	873,936.30	474,939.90	54.34
93540 ARSIMI FILLOR	8,702,840.12	5,333,853.42	61.29
94740 ARSIMI I MESËM	3,588,480.68	2,150,590.78	59.93

13 MALLRA DHE SHËRBIME	5,875,733.02	2,679,561.56	45.60
16019 ZYRA E KRYETARIT	72,500.00	36,573.28	50.45
16319 ADMINISTRATA	2,342,000.00	1,198,006.32	51.15
16519 ÇËSHTJE GJINORE	12,000.00	104.00	0.87
16559 INTEGRIMET EVROPIANE	2,000.00	0.00	0.00
16637 INSPEKSIONI	82,500.00	8,607.96	10.43
16795 PROKURIMI	1,000.00	0.00	0.00
16919 ZYRA E KUVENDIT KOMUNAL	44,000.00	1,345.10	3.06
17519 BUXHETI	62,269.49	20,615.20	33.11
18019 SHËRBIME PUBLIKE - INFRASTRUKTURA RRUGORE	1,127,523.00	548,730.29	48.67
18295 SHËRBIMET E ZJARRFIKËSVE	46,500.00	8,063.73	17.34
19595 ZYRA LOKALE E KOMUNITETEVE	13,500.00	0.00	0.00
47019 BUJQËSIA	93,000.00	39,068.79	42.01
48019 PLANIFIKIMI DHE ZHVILLIMI EKONOMIK	43,748.12	20,842.02	47.64
65095 SHËRBIMET KADASTRALE	3,000.00	0.00	0.00
65495 ÇËSHTJET LIGJORE	3,000.00	1,034.00	34.47
66100 PLANIFIKIMI HAPËSINOR DHE RREGULLATIV	31,000.00	10,475.15	33.79
73028 ADMINISTRATA	2,000.00	0.00	0.00
74100 SHËRBIMET E KUJDESIT PRIMAR SHËNDETËSOR	515,192.00	237,093.33	46.02
75591 SHËRBIMET SOCIALE	16,700.00	4,009.40	24.01
75592 SHËRBIM.REZIDENCIALE	45,000.00	35,687.55	79.31
85019 SHËRBIMET KULTURORE	334,362.82	143,048.50	42.78
85184 TEATRI	17,704.00	9,106.59	51.44
92095 ADMINISTRATA	534,021.00	210,680.62	39.45
92570 ARSIMI PARAFILLOR ÇERDHET	286,188.00	88,707.37	31.00
93540 ARSIMI FILLOR	80,005.00	39,951.37	49.94
94740 ARSIMI I MESËM	65,019.59	17,810.99	27.39

14 SHPENZIME KOMUNALE	1,107,240.00	632,045.40	57.08
16319 ADMINISTRATA	117,500.00	61,101.06	52.00
18019 SHËRBIME PUBLIKE - INFRASTRUKTURA RRUGORE	511,040.00	296,234.68	57.97
18295 SHËRBIMET E ZJARRFIKËSVE	19,500.00	4,406.94	22.60
74100 SHËRBIMET E KUJDESIT PRIMAR SHËNDETËSOR	156,000.00	83,818.22	53.73
75591 SHËRBIMET SOCIALE	20,200.00	9,185.84	45.47
75592 SHERBIM.REZIDENCIALE	5,000.00	833.00	16.66
85019 SHËRBIMET KULTURORE	78,000.00	45,053.13	57.76
85184 TEATRI	5,000.00	1,999.92	40.00
92095 ADMINISTRATA	195,000.00	129,412.61	66.37
20 SUBVENCIONE DHE TRANSFERE	1,384,231.32	410,130.00	29.63
16019 ZYRA E KRYETARIT	282,000.00	179,785.68	63.75
16519 ÇËSHTJE GJINORE	10,000.00	2,000.00	20.00
47019 BUJQËSIA	500,000.00	0.00	0.00
48019 PLANIFIKIMI DHE ZHVILLIMI EKONOMIK	119,714.32	19,714.32	16.47
74100 SHËRBIMET E KUJDESIT PRIMAR SHËNDETËSOR	63,000.00	29,800.00	47.30
75591 SHËRBIMET SOCIALE	90,000.00	90,000.00	100.00
85019 SHËRBIMET KULTURORE	269,870.00	88,830.00	32.92
85184 TEATRI	49,647.00	0.00	0.00
30 KAPITALET	16,380,974.50	2,808,633.57	17.15
16319 ADMINISTRATA	511,000.00	0.00	0.00
17519 BUXHETI	636,104.53	43,035.31	6.77
18019 SHËRBIME PUBLIKE - INFRASTRUKTURA RRUGORE	9,729,410.48	1,752,079.31	18.01
19595 ZYRA LOKALE E KOMUNITETEVE	200,000.00	0.00	0.00
47019 BUJQËSIA	652,015.49	0.00	0.00
48019 PLANIFIKIMI DHE ZHVILLIMI EKONOMIK	181,286.00	27,735.00	15.30
66100 PLANIFIKIMI HAPËSINOR DHE RREGULLATIV	135,000.00	0.00	0.00
74100 SHËRBIMET E KUJDESIT PRIMAR SHËNDETËSOR	290,000.00	33,623.20	11.59
75592 SHERBIM.REZIDENCIALE	355,789.00	50,000.00	14.05
85019 SHËRBIMET KULTURORE	630,000.00	0.00	0.00
93540 ARSIMI FILLOR	1,060,369.00	0.00	0.00
94740 ARSIMI I MESEM	2,000,000.00	902,160.75	45.11
Totali I Përgjithshëm	46,073,925.44	18,793,479.16	40.79



KOMUNA E PEJES
OPŠTINA PEÇ
MUNICIPALITY OF PEJA

Drejtoria Komunale e Arsimit- Nr.prot. 480/23		PERIUDHA RAPORTUE SE
Naser Gega		JANAR – dhjetorTM 1-dhe TM 2
Naser gega@rks-gov.net		DATA:korri korrik
044-221-164		2026

Nr. Ref	Përshkrimi i punëve dhe detyrave të punës duhet të behën sipas planit të prokurimit, bazuar ne buxhetin e parapare për investime kapitale për vitin 2026	Muaji i realizimit përfshirë edhe procedurë n e prokurimit	Çmimi i planifikuar në Euro
1.	Furnizimi dhe servisimi me material elektrik per nevojat e shkollave	Shkurt 2026	10,000.00
2.	Furnizimi me material te ndryshem per sistemin e ujesjellsit dhe sanitaris ne Shkolla	Shkurt 2026	15,000.00
3.	Blerja e kositesve dhe veglave te punes per nevojat e shkollave	Shkurt 2026	5,040.00
4	Furnizimi me material per mirembajtjen e objektev arsimore	Shkurt 2026	25,000.00
5	Rindertimi dhe renovimi I salles se sportit IAAP”Rifat Gjota”	Mars 2026	42,653.09
6.	Rindertimi dhe renovimi I salles se sportit ne shkollen fillore”Lidhja e Pejes”	Mars 2026	52,070.00
7.	Rindertimi dhe renovimi I strehes ne sallën e sportit te shkolles Lidhja e Prizrenit	Mars 2026	17,527.00
8.	Rindertimi dhe renovimi I shkolles”Pjeter Budi” Dardania 3	Mars 2026	64,550.00
9.	Renovimi I kulmit te salles se sportit ne shkollen fillore Lidhja e Pejes , Novosell	Mars 2026	36,732.5
10	Ndertimi I Salles se sportit ne Fashatin Trestenik	Maj 2026	569,079.87
11	Blerja e kombibusve per Shkolla dhe automjetit transportues	Qershor 2026	230,000.00
12	Furnizimi me lende Djeges –Dru per intitucionet Arsimore	Maj 2026	204,400.00

Raporti vjetor i punës në DKA gjatë vitit 2026 TM1 dhe TM2

•Mbledhje me drejtorët e shkollave –përgaditjet për fillimin e gjysëmvetorit të dytë të vitit shkollor 2025/2026

- Shpallja e konkursit për plotësimin e vendeve të lira të punës (pensionimet) dhe zëvendësimet e përkohshme (pushime të lindjes ,pushime mjekësore)
- Organizimi dhe transporti 17 nxënësve të cilët fituan të drejtën të marrin pjesë në garat e Olimpiadës së Matematikës në nivel Kosovës -10 janar 2026
- Përditësimi i të dhënave për stafin në shkolla - janar,shkurt 2026
- Mbledhja e raporteve të punës së drejtorëve dhe zv.drejtorëve të shkollave ,për periudhën Korrik-Dhjetor 2025 - deri më 15 Janar 2026
- Analiza e suksesit dhe mungesave të nxënësve për gjysmëvetorin e parë të vitit shk.2025/26
- Sigurimi i mbajtjes së mësimit alternativ në IAAP”Rifat Gjota” ,për nxënësit e pezulluar nga ShMLT”Nexhmedin Nixha” nga komuna e Gjakovës-janar,shkurt,mars 2026
- Raportimi në SMPK për Performance e Komunës (fusha e arsimit) –shkurt 2026
- Bashkëpunimi i DKA-së me Drejtorin Rajonale të Policisë për Komunitet dhe Parandalim, për ligjerimin nëpër shkolla me temën -Respektimi i shumëllojshmërisë së shoqërisë me qëllim të parandalimit të ekstremizmit dhe radikalizmit të dhunshëm , klasat e VIII-XII –Shkurt 2026
- Organizimi i Olimpiadës së Kimisë në nivel shkolle dhe në nivel Komunal –Shkurt,Mars 2026
- Shënimi i Epopesë së UÇK-së në shkolla – 5 Mars
- Nga Komisioni përzgjedhës në DKA,mësimdhënësi më i dalluar nga shkollat e Komunës së Pejës,u nominua mësimdhënësjja /edukatore Valbona Dautaj e cila përfaqësoj komunën e Pejës në përzgjedhjen për çmimin “Shaban Jashari” me datë 7 mars 2026
- Organizimi nga DKA i drekës solemne dhe shpërndarja e mirënjohjeve për 42 mësimdhënësit e pensionuar (nga data 7 mars 2025 -7 mars 2026) dhe 3 mirënjohje postmortum, për nderë të 7 Marsit –ditës së Mësuesit.
- Zhvillimi i procedurave të rekrutimit të puntorëve të rinjë (testet me shkrim,intervista vendimet per pranim,etj) -janar-shkurt 2026
- Takim i organizuar nga DKA dhe MASH- Divizionit për Planprograme dhe Tekste Shkollore me mësimdhënësit të nivelit 1-5 dhe 6-9 me qëllim të rishikimit të teksteve shkollore të përdorura gjatë vitit shkollor 2025/26 (muaji shkurt dhe prill)
- Bashkëpunimi i DKA-së me Drejtorin Rajonale të Policisë për ligjerimin nëpër shkolla me temën:Parandalimi i ngacmimeve seksuale dhe masat ligjore ndëshkimore , me nxënës të klasave VII dhe XII- muaji Mars
- Punëtori dyditore në Durrës me zyrtarë komunal,zyrtarë të arsimit ,drejtor dhe zv.drejtor të shkollave.Temat e diskutuara ishin lidhur me planifikimet e buxhetit për vitin shkollor 2026/27 dhe propozimet për hartimin e Draft Strategjisë së Arsimit – 3 dhe 4 Prill 2026

- Përkrahje DKRS në organizimin e garave sportive me nxënës të shkollave të mesme të larta nga 17 komuna –Gjimnaziada 2026 (15,16 dhe 17 prill 2026)
- Përzgjedhja e anëtarëve të Asamblesë komunale të Fëmijëve (AKF) për mandatin 2026-2028 në koordinim me Zyrën për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe Riintegrim (20.04.2026 deri më 14.05.2026)
- Organizim i takimit të zyrtarëve të arsimit dhe mësimdhënësve me përfaqësues të Institutit Pedagogjik në kuadër të projektit Fulbright Specialist, të mbështetur nga Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë . Takimi u mbajt në Asamblenë Komunale (28.04.2026)
- Organizimi i Olimpiadës II të Përbashkët (Kosovë- Shqipëri) në lëndën e Gjuhës Shqipe me nxënës të klasëve të nënta (faza e pare dhe e dytë)- muaji Prill dhe Maj 2026
- Organizimi i vizitave të nxënësve nga shkollat profesionale dhe shkollat e mesme të ulëta në kuadër të manifestimit “Java e dyerve të hapura “- 04 deri më 08.05.2026
- Vlerësimi i Strategjisë së Arsimit 2022–2026 për vitin 2025 –raportim në MASH (Prill-Maj 2026)
- Planifikimi i Qendrave për Test të Arritshmërisë 2026 dhe përzgjedhja e administruesve (Prill ,Maj 2026)
- Organizimi i trajnimit të mësimdhënësve/administruesve të Testit Kombëtar të Maturës 2026 nga zyrtarja e arsimit të mesëm të lartë dhe përfaqësuesve nga Qendra e Vlerësimeve MASH, në Asamblenë Komunale - 6 Maj 2026
- Organizimi i manifestimit”Festa e Abetares “ në nivel regional. Koordinator regional i këtij manifestimi ishte DKA në Pejë ,ndërsa për përfaqësim në nivel qendror u përzgjedh ShFMU”Bajram Curri “ Istog (20.05.2026)
- Pjesëmarrje e zyrtareve të arsimit në Tryezën Multidisciplinare për Ndihmë në Menaxhimin e Rastit (TNMR), e organizuar nga Zyra e UNICEF-it në bashkëpunim me Departamentin për Politika të Shërbimeve Sociale dhe Familjare / MPFVLÇ (25 dhe 26 Maj 2026)
- Organizimi i disa aktiviteteve (ligjërata në shkolla, gara në vizatime dhe video inçizime , ekspozita), me nxënës të shkollave ,me qëllim të shënimit të Ditës Ndërkombëtare kundër Duhanit -31 Majit , me moton “Zbulimi i joshjes – luftimi i varësisë nga nikotina dhe duhani” .Organizimi është realizuar në bashkëpunim me shkollat, IKSHPK dhe DKRS. Video me mesazhe vetëdijësuese e realizuar nga nxënës dhe mësimdhënës të ShFMU”28 Nëntori “ Raushiq u shpërblye me çmimin e pare nga IKSHPK në nivel qendror
- Shënimi i Ditës së Fëmijëve -1 Qershorit në bashkëpunim me shkollat
- Planifikimi dhe regjistrimi i nxënësve në klasë parafillore dhe klasë të parë
- Vlerësim i performances së shtatë drejtorëve të shkollave të cilët janë në vitin e fundit të mandatit katërvjeçar (periudha e vlerësimit Mars- Shator 2026)
- Planifikimi i regjistrimit të nxënësve në klasa të 10-ta në gjimnaze dhe shkolla profesionale- 1 qershor 2026
- Përzgjedhja e mësimdhënësve si anëtar të komisionit për Maturën shtetërore 2026

- Organizimi I testit të Maturës 2026 me dt 20.06.2026
- Shpallja e rezultateve të testit të Maturës 2026 -Rezultati është 75% në nivel Komunal
- Realizimi i testit të Arritshmërisë 2026 me dt 26.06.2026
- Rezultati testit të Arritshmëri mesatarja në nivel komunal - 48.1
- Vizitë treditore,studimore në Bursa nga 2 zyrtar të DKA-së ,drejtori dhe zv .drejtori i IAAP" Rifat Gjota" si dhe 9 nxënës nga ky institucion –qershor 2026

Raport i realizimit të i aktiviteteve nga Zyra e Arsimit Gjithpërfshirës

- Pranimi i kërkesave për inicimin e rasteve për vlerësim pedagogjik të fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore
- Analiza e raporteve dhe instrumenteve për vlerësim pedagogjik të fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore
- Vlerësimi pedagogjik i fëmijëve me NEV arsimore sipas kërkesave nga shkollat
- Numri total i fëmijëve me NEV arsimore të vlerësuar nga ana e Ekipit Vlerësues Komunal,në periudhën janar -qershor është 15 nxënës, ku prej tyre 13 djem dhe 2 vajza.
- Shpërndarja e vendimeve dhe rekomandimeve nga Ekipi Pedagogjik për shkollën dhe familjen
- Mbledhja e raporteve mujore të punës së psikologeve dhe asistenteve të fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore
- Takime me psikolog , asistent të fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore dhe mësues udhëtues nga Qendrat Burimore

Administrata

- Përgjigje në kërkesa dhe ankesa të palëve , bazuar në ligj dhe vendosja në programin INTRANET
- Shpallja e konkurseve për mësimdhënës, plotësimi i vendeve të liruara (pushimet e lindjes)
- Pranimi dhe shqyrtimi i Aplikacioneve në konkurset e shpallura.
- Regjistrimi i faturave hyrëse dhe dalëse të mallrave në sistemin e –pasuria
- Skanimi dhe arkivimi elektronik dhe arkivimi fizik i të gjitha faturave
- Zbatimi i detyrave administrative si: vendimet e ndryshme ligjore për mësimdhënës dhe palë të tjera,kontratat e punës, vendimet për ndërprerje të marrdhënies së punës,pa pagesë, pushimet e lehonisë etj


- Pëlqime, rekomandime, njoftime për shkolla
- Ankesa ndaj vendimeve të inspektoriatit
- Pjesëmarrja në vendime të komisioneve disiplinore, të ankesave etj.
- Vizita të rregullta në institucionet arsimore me qëllim të monitorimit të gjendjes në shkolla.

Raport i realizimit të i aktiviteteve nga Zyrtari për Teknologji Informative

- Mirëmbajtja dhe mbështetja teknike në shkolla
- Diagnostikimi dhe zgjidhja e problemeve teknike në kompjuterë, printerë, fotokopje dhe pajisje të tjera IT.
- Formati i kompjuterëve, instalim i Windows, Office dhe programeve të nevojshme.
- Lidhja dhe konfigurimi i printerëve të rinj dhe ekzistues.
- Mbështetje e vazhdueshme për përdorimin e sistemeve elektronike.
- Menaxhimi i Pajisjeve të Sigurisë
- Zëvendësim i transformatorëve të djegur, kablllove dhe furnizimeve të energjisë.
- Raste të djegies së DVR-ve, të cilat janë zëvendësuar ose rekomanduar për zëvendësim.
- Inventarizimi i pajisjeve të vjetra dhe përpilimi i listave për pajisje të reja.
- Konfigurimi i rrjeteve LAN, vendosja e kablllove të reja dhe rregullimi i pikave të internetit.
- Mbështetje për rrjetet WiFi dhe pajisjet e aksesit.
- Shërbime Software dhe Llogari Përdoruesi (ndihmë për Outlook/Exchange, rikthim fjalëkalimesh dhe konfigurim në telefon).
- Projekte të Shtuar (përgatitja e listave për pajisjet IT të nevojshme për Drejtorinë, mbështetje teknike për aktivitete dhe punë administrative).
- Vendosja dhe konfigurimi i sistemeve të sigurisë në një numër të madh shkollash.

Sektori i Financave

- Përcjellja e ndryshimeve në listen e pagave Janar-qershor 2026
- -Zotimi i mjeteve dhe regjistrimi ne formë kompjuterike
- -Percjellja e mjeteve te alokuara dhe mjeteve te shpenzuara
- Analiza e buxhetit rreth raportit planifik-shpenzim per periudhe janar – qershor 2026
- Futja e te dhënave per komunalit ne databazen e instaluar nga zyra e IT-se se Komunes.



**RAPORTI GJASHTËMUJOR I PUNËVE
TË KRYERA DHE AKTIVITETEVE
NGA DREJTORIA E
BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE
HIDROEKONOMISË**

QERSHOR 2026

Përmbajtja:

1.LLOJI DHE NUMRI I KËRKESAVE

1.1. Tabela e kërkesave të ndara sipas numrit dhe statusit

1.2. Tabela e kërkesave sipas kategorive

1.2.1. Inksasimet e të hyrave nga vendimet për ndërrim të destinacionit të tokës

2.SUBVENCIONET NGA DREJTORIA E BUJQËSISË

2.1 Përkrahja e fermerëve me fidane të mjedrës

2.2 Përkrahja e fermerëve me fidane të specit sombork dhe trangullit kornishon

2.3 Përkrahja e fermerëve me mekanizëm bujqësor - Traktor

3.INVESTIMET KAPITALE

3.1 Planifikimi i inv.kapitale (kanaleve të ujitjes) për vitin 2026-2027

3.2 Monitorimi i kontratave dy vjeçare nga viti i kaluar

4.MARRËVESHJET E BASHKËPUNITIT ME OJQ

5.AKTIVITETET E DBPH

- Takim me perfaqesuesin e pikes grumbulluese Agrocelina z.Afrim Rexhepi, me qellim te arritjes se nje dakordimi ne parim per realizimin e nje projekti te partneritetit publiko-privat
- Takim me fermeret perfitues te fidaneve te mjedres
- Takim konsultativ me grate fermere te Komunes se Pejës
- Nenshkrimi i marreveshjes se bashkepunimit me IRK per subvencionimin e fermereve te Komunes se Pejës me paisje bujqesore dhe sera
- Takim me fermeret perfitues te fidaneve te specit dhe trangujve
- Shperndarja e fidaneve dhe inputeve per fermeret perfitues
- Nenshkrimi i marreveshjes me kompaninë “Drini i Bardhë “ SH.A për lehtësimin e ujtjes se tokave per fermeret
- Vizitë në terren tek perfituesit e fidaneve të mjedrës
- Vizitë në terren tek perfituesit e fidaneve të specit dhe trangujve
- Shpërndarja e paisjeve bujqësore me IRK tek fermerët përfitue

6.SUBVENCIONET E MBPZHR

6.1Afati i aplikimit për TM2 i vitit 2025

6.2 Afati i aplikimit në Programin e Pagesave Direkte për sipërfaqet e mbjellura me kultura bujqësore të përcaktuara në PPD 2026

Ky raport gjashtëmuor paraqet përmbledhjen e aktiviteteve, angazhimeve dhe rezultateve të punës së Drejtorisë së Bujqësisë gjatë periudhës së parë gjashtëmuore të vitit 2026. Qëllimi i raportit është të ofrojë një pasqyrë të qartë mbi realizimin e detyrave dhe objektivave të planifikuara, zbatimin e politikave dhe programeve në sektorin e bujqësisë, si dhe mbështetjen e ofruar për fermerët dhe zhvillimin e zonave rurale.

Gjatë kësaj periudhe, Drejtoria e Bujqësisë është angazhuar në zbatimin e aktiviteteve që synojnë rritjen e prodhimit të bujqësorë, përmirësimin e kushteve për fermerët, administrimin e programeve komunale të subvencionimit, bashkëpunimin me institucionet përkatëse, si dhe ofrimin e shërbimeve profesionale dhe këshillimore për komunitetin bujqësor.

1. LLOJI DHE NUMRI I KËRKESAVE

Gjatë periudhës raportuese, Drejtoria e Bujqësisë ka pranuar dhe shqyrtuar një numër të konsiderueshëm lëndësh dhe kërkesash nga qytetarët, fermerët dhe subjektet e ndryshme, duke vepruar në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe procedurat administrative.

Një pjesë e rëndësishme e lëndëve ka të bëjë me kërkesat për marrje me qira të tokës bujqësore në pronësi komunale. Këto kërkesa janë trajtuar përmes verifikimit të dokumentacionit përkatës, vlerësimit të kushteve ligjore dhe procedurave të parapara për shfrytëzimin e tokës komunale, me synim përdorimin sa më efikas të saj dhe mbështetjen e zhvillimit të veprimtarisë bujqësore.

Gjithashtu, Drejtoria ka shqyrtuar kërkesat për ndryshimin e destinimit të tokës, duke analizuar secilin rast në përputhje me dispozitat ligjore dhe dokumentet e planifikimit hapësinor. Këto procedura janë zhvilluar në bashkëpunim me drejtoritë dhe institucionet kompetente, me qëllim që çdo vendimmarrje të jetë në përputhje me interesin publik dhe zhvillimin e qëndrueshëm.

Po ashtu, gjatë kësaj periudhe janë trajtuar edhe kërkesat për ndryshimin e kulturës së tokës bujqësore. Për secilën kërkesë është bërë vlerësimi teknik dhe administrativ, duke marrë parasysh gjendjen faktike në terren, dokumentacionin e nevojshëm dhe kriteret e përcaktuara me legjislacionin përkatës.

Të gjitha lëndët janë administruar dhe trajtuar në afatet e parapara, me përkushtim për ofrimin e shërbimeve efikase, transparente dhe në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Llojet e kërkesave të parashtruara	
1.	Kërkesa për përfitim nga skemat e subvencionimit dhe grantet bujqësore
2	Kërkesa për regjistrim dhe verifikim të fermave dhe parcelave bujqësore
3.	Kërkesa për këshillim teknik dhe profesional në fushën e bujqësisë dhe blegtorisë
4.	Kërkesa për përdorimin, shfrytëzimin dhe ndrrimin e destinimit të tokës bujqësore
5.	Kërkesa për ndrrim të kulturës
6.	Kërkesa për marrje me qera të tokës bujqësore komunale
7.	Kërkesa për regjistrin në sistemin eFr
8.	Kërkesa për trajtimin e problematikave nga qentë endacak

1.1 Në tabelën e posht-shënuar janë të paraqitura kërkesat e ndara sipas numrit dhe statusit të shqyrtimit të lëndëve:

	Të pranuar	Në proces	Të miratuara	Të refuzuara	Hedhur poshtë	Të anuluar
	1,167 kërkesa	336 kërkesa	209 kërkesa	611 kërkesa	6 kërkesa	4 kërkesa

- **1.1.1 Kërkesa për marrje me qira të tokës bujqësore komunale:** 9 aplikues si person fizik. Aplikues si person juridik nuk kemi pasur.
Kjo taksë është vendosur në Rregulloren Nr. 02-2025 Për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores Nr. 02-2023 (KPE) për Taksa Komunale dhe konfirmimin e ligjeshmerisë, të Seancës së rregulltë të dt. 29.05.2025.

Totali/ ha i spërfaqes së leshuar të tokës komunale me qera për këtë vit : **26.39ha**

Të hyra : 1,707.13 Euro.

- **1.1.2 Ndrrimi i destinacionit të tokës:** 15 aplikues, si person juridik 1 dhe 14 aplikues si persona fizik.
Totali i të hyrave – 12,695.25 €

2. SUBVENCIONET E D.B.P.H

2.1 Drejtoria për Bujqësi e Komunës së Pejës ka hapur thirrjen publike për aplikim më datë 09.02.2026 për realizimin e projektit ***“Zgjerimi dhe zhvillimi i kultivimit të mjedrës në Komunën e Pejës”***, me një sipërfaqe totale prej 2 hektarësh.

Në kuadër të kësaj thirrjeje kanë përfituar 10 fermerë, të cilët janë mbështetur me fidane të mjedrës, së bashku me materialet përcjellëse të parapara në projekt-propozim, me qëllim të ngritjes dhe zhvillimit të sipërfaqeve të reja të kultivimit të mjedrës.

Ky projekt është realizuar përmes modelit të bashkëfinancimit, ku Komuna e Pejës ka financuar 60% të vlerës totale të projektit, ndërsa fermerët përfitues kanë bashkëfinancuar 40% të vlerës së përgjithshme.

Përmes këtij projekti synohet rritja e kapaciteteve prodhuese, përmirësimi i të ardhurave të fermerëve dhe zhvillimi i mëtejshëm i sektorit të kultivimit të mjedrës në territorin e Komunës së Pejës.

2.2 Drejtoria e Bujqësisë e Komunës së Pejës, me datë 27.02.2026, ka hapur thirrjen publike për aplikim në kuadër të projektit ***“Rritja e prodhimit të specit (Somborka dhe Kurtovka) dhe trangullit kornishon në zonat rurale të Komunës së Pejës për treg të garantuar”***.

Qëllimi i këtij projekti ishte mbështetja e fermerëve në rritjen e prodhimit vendor, përmirësimi i të ardhurave të tyre dhe sigurimi i një tregu të garantuar për produktet e kultivuara. Në kuadër të projektit, Drejtoria e Bujqësisë ka subvencionuar fermerët përfitues me fidanë cilësorë dhe të gjitha materialet përcjellëse të nevojshme për kultivim.

Nga kjo thirrje publike kanë përfituar gjithsej 35 fermerë, të cilët kanë realizuar kultivimin e 1 hektari spec (Somborka dhe Kurtovka) në fushë të hapur dhe 2.5 hektarë trangull kornishon në serra.

Ky projekt përfaqëson një mbështetje të rëndësishme për zhvillimin e sektorit të perimtarisë në zonat rurale të Komunës së Pejës, duke nxitur prodhimin vendor, rritjen e konkurrueshmërisë së fermerëve dhe krijimin e mundësive për një shitje të sigurt të produkteve bujqësore.

2.3 Në baztë planifikimit buxhetor dhe Planit të Prokurimit, Drejtoria për Bujqësi ka shpallur thirrje publike për aplikim me datë 22.05.2026 për ***projektin “Furnizim me mekanizëm bujqësor – Traktor”*** participim me fermerë ku gjithsejt kanë qenë 235 aplikime.

Pas përfundimit të procedurave të aplikimit dhe vlerësimit, nga kjo thirrje kanë përfituar 65 fermerë. Sipas kushteve të projektit, financimi realizohet me bashkëfinancim, ku 60% e vlerës së projektit mbulohet nga Komuna, ndërsa 40% nga fermeri përfitues.

Ky projekt synon të mbështesë modernizimin e sektorit të bujqësisë, rritjen e kapaciteteve prodhuese dhe përmirësimin e kushteve të punës për fermerët. Duke marrë parasysh rëndësinë dhe interesimin e madh të fermerëve, projekti është planifikuar të vazhdojë edhe gjatë tre viteve të ardhshme, me qëllim që një numër edhe më i madh i fermerëve të përfitojnë nga kjo mbështetje.

3. INVESTIMET KAPITALE

Gjatë periudhës raportuese, Drejtoria e Bujqësisë ka vazhduar angazhimin në realizimin e investimeve kapitale, me fokus përmirësimin e infrastrukturës bujqësore dhe krijimin e kushteve më të mira për zhvillimin e prodhimit bujqësor në territorin e Komunës së Pejës.

Në kuadër të planit të investimeve për këtë vit, Drejtoria ka iniciuar procedurat e prokurimit për realizimin e projektit të ndërtimit dhe rehabilitimit të kanaleve të ujitjes, i cili është ndarë në pesë (5) lote. Ky investim synon përmirësimin e sistemit të ujitjes, rritjen e kapaciteteve për furnizim me ujë të sipërfaqeve bujqësore dhe krijimin e kushteve më të favorshme për zhvillimin e kulturave bujqësore. Procedurat tenderuese janë zhvilluar në përputhje me legjislacionin në fuqi për prokurimin publik dhe, pas përfundimit të tyre, pritet të fillojë realizimi i punimeve sipas dinamikës së planifikuar.

Njëkohësisht, gjatë kësaj periudhe është vazhduar me realizimin e punimeve të mbetura nga kontratat e investimeve kapitale të vitit të kaluar. Punimet janë zhvilluar sipas planit të zbatimit dhe aktualisht ndodhen në fazën përfundimtare, me pritje që të përmbyllen në afatin e paraparë.

NË TABELEN E MËPOSHTME JANË TË PARAQITURA PROJEKTET E NDARA NË 5 LOTE QË DO TË KONTRAKTOHEN:

Nr.	Projekti	Vlera e parashikuar e kontratës	Të paguara	Përfunduar/ Në proces	Pagesat në % të punëve të realizuara
1.	Ndërt. i kanaleve të ujitjes në fshatrat e Lugut të Baranit LOT 1	309,108.50			
2.	Ndërt. i kanaleve në fshatrat e Lugut të Leshanit LOT 2	87,500.00			
3.	Ndërtimi i kanaleve të ujitjes në fshatrat e Lugut të Trestenikut LOT 3	301 979.50			
4.	Ndërtimi i kanaleve të ujitjes në fshatrat e Podgurit LOT 4	301,979.50			
5.	Ndërtimi i kanaleve të ujitjes Fusha e Pejës LOT 5	199,432.50			

Realizimi i këtyre investimeve ka kontribuar në sigurimin e ujit për sipërfaqe të konsiderueshme bujqësore, rritjen e produktivitetit të kultivimeve ,zvogëlimin e humbjeve të ujit dhe përmirësimin e qendrueshmërisë së bujqësisë në zonat rurale.

4.Marrëveshjet e bashkëpunimit me OJQ dhe subvencionimi i fermerëve

Gjatë periudhës gjashtëmujore, Drejtoria e Bujqësisë ka vazhduar angazhimin e saj në krijimin dhe forcimin e bashkëpunimit me organizata, institucione dhe partnerë të ndryshëm, me qëllim mbështetjen e zhvillimit të sektorit bujqësor dhe përmirësimin e kushteve për fermerët. Në kuadër të këtij bashkëpunimi janë arritur marrëveshje për zbatimin e programeve të përbashkëta, të cilat synojnë rritjen e prodhimtarisë bujqësore, modernizimin e fermave, përmirësimin e teknologjisë së prodhimit dhe fuqizimin ekonomik të fermerëve.

Përmes këtyre marrëveshjeve, fermerët kanë përfituar mbështetje në formën e inputeve bujqësore, pajisjeve, materialit fidanor dhe faror, mekanizimit bujqësor, si dhe formave të tjera të asistencës, në përputhje me kriteret dhe programet e përcaktuara nga partnerët bashkëpunues.

Në kuadër të bashkëpunimit me organizatën Islamic Relief Kosova, janë shpërndarë pajisje bujqësore dhe sera me sipërfaqe prej 1 ari për 111 fermerë. Ky projekt është realizuar me bashkëfinancim, ku fermerët kanë participuar me 28% të vlerës së investimit, ndërsa Komuna e Pejës ka mbuluar 72% të kostos.

5.AKTIVITET E D.B.P.H-së

Gjatë periudhës gjashtëmujore, Drejtoria e Bujqësisë ka zhvilluar një sërë aktivitetesh në terren, me qëllim ofrimin e mbështetjes profesionale për fermerët, monitorimin e zbatimit të projekteve dhe identifikimin e nevojave të sektorit bujqësor.

Zyrtarët e Drejtorisë kanë realizuar vizita të rregullta në fermat dhe parcelat bujqësore në të gjitha zonat e Komunës së Pejës, ku kanë ofruar këshilla teknike për kultivimin e kulturave bujqësore, menaxhimin e fermave, mbrojtjen e bimëve, përdorimin e praktikave të mira bujqësore dhe zbatimin e masave për rritjen e rendimentit dhe cilësisë së prodhimit.

Një pjesë e rëndësishme e aktiviteteve në terren ka qenë verifikimi dhe monitorimi i përfituesve të programeve komunale të subvencionimit dhe projekteve të realizuara në bashkëpunim me organizata dhe partnerë zhvillimorë. Gjatë këtyre vizitave është verifikuar përmbushja e kriterëve të përcaktuara, përdorimi i drejtë i mbështetjes së dhënë dhe realizimi i investimeve sipas kushteve të programeve.

Po ashtu, Drejtoria ka zhvilluar takime të rregullta me fermerë, përfaqësues të shoqatave bujqësore, organizata partnere dhe institucione relevante. Këto takime kanë shërbyer për informimin mbi programet e mbështetjes, diskutimin e sfidave me të cilat përballen fermerët, shkëmbimin e përvojave dhe koordinimin e aktiviteteve për zhvillimin e sektorit bujqësor.

Përmes pjesëmarrjes në takime, vizitave në terren dhe komunikimit të vazhdueshëm me fermerët, Drejtoria e Bujqësisë ka siguruar një bashkëpunim të ngushtë me komunitetin bujqësor, duke kontribuar në zgjidhjen e problemeve praktike, përmirësimin e shërbimeve ndaj fermerëve dhe zbatimin me sukses të programeve dhe projekteve gjatë periudhës raportuese.

FOTO NGA AKTIVITETET E LARTËPERMENDURA:



1. Takim me perfaqesuesin e pikes grumbulluese Agrocelina z.Afrim Rexhepi, me qellim te arritjes se nje dakordimi ne parim per realizimin e nje projekti te partneritetit publiko-privat



2. Takim me fermeret perfitues te fidaneve te mjedres



3. Takim konsultativ me grate fermere te Komunes se Pejës



4. Nenshkrimi i marreveshjes se bashkepunimit me IRK per subvencionimin e fermereve te Komunes se Pejes me paisje bujqesore dhe sera



5.Takim me fermeret perfitues te fidaneve te specit dhe trangujve



6.Shperndarja e fidaneve dhe inputeve per fermeret perfitues



7. Nenshkrimi i marreveshjes me kompaninë “Drini i Bardhë “ SH.A për lehtësimin e ujtijes se tokave per fermeret



8. Vizitë në terren tek perfituesit e fidaneve të mjedrës



9. Vizitë tek përfituesit e fidaneve të specit dhe trangujve




10. Nënshkrimi i kontratave me përfituesit e paisjeve bujqësore dhe sera



11. Shpërndarja e paisjeve bujqësore me IRK tek fermerët përfitues

6.SUBVENCIONET E MBPZHR-së (PPD)

Nga dt.19.01-18.02.2026, MBPZHR-ja ka shpallur thirrje për aplikim për TM2(subvencionim për qumësht sipas cilësisë,viça për majmëri, therrje dhe akuakulturë) për vitin 2025.



Programi për Pagesa Direkte për vitin 2026 nga MBPZHR-ja është hapur me dt.22.06.2026 dhe do të zgjasë deri me 21.07.2026.

Gjatë këtij afati fermerët aplikojnë për kulturat e mbjellura bujqesore si dhe per bagëti.

Gjthsejt këtë vitit pritet të aplikojnë rreth 2000 fermerë.

PËRMBLEDHJE:

✚ Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2026, Drejtoria e Bujqësisë përmes subvencioneve ka ndihmuar **221** fermerë me paisje të ndryshme bujqësore, sera, fidane të mjedres, specit dhe trangujve, në menyre që të krijohen kushte me të mira të punës:

- Sera 1 ari- 50 copë
- Freza 1.8 -14 copë
- Freza 2.0 -15 copë
- Makina mbjellese te misrit – 14 copë
- Rotokosa – 18 copë
- Fidane te mjedres – 10 fermer
- Fidane te specit dhe trangullit – 35 fermerë
- Traktor – 65 copë

✚ Nga Drejtoria janë duke u ndihmuar 2000 fermerë për përgaditjen e dokumentacionit dhe aplikim në sistemin elektronik eFR gjatë afateve të subvencioneve të shpallura nga MBPZHR, me gjithsej **9000ha** të mbjellura nga kultura të ndryshme bujqësore.

-



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E PEJËS * MUNICIPALITY OF PEJA * OPŠTINA PEĆ



Raport i Punës Janar - Qershor 2026

Pejë, Korrik 2026

DREJTORIA PËR ÇËSHTJE PRONËSORE-JURIDIKE

R A P O R T I P U N Ë S

Janar – Qeshor 2026

REFERENCA :	Raport i Punës
Datë/Datum/Date	10 Korrik 2026
PËR/ZA/TO	Z. Gazmend Muhaxheri - Kryetar i Komunës së Pejës
PËRMES/PREKO/THROUGH	Arianit Krasniqi – Drejtor në Drejtorinë për Çështje Pronësore-Juridike
NGA/OD/FROM	Drejtoria Për Çështje Pronësore - Juridike – Pejë
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT	RAPORTI I PUNËS: JANAR – QERSHOR 2026

RAPORT I PUNËS JANAR – QERSHOR 2026

Gjatë kësaj periudhe raportuese, Drejtoria për Çështje Pronësore - Juridike ka realizuar punët e listuara si më poshtë:

- Drejtoria për Çështje Pronësore-Juridike nga Janari deri më tani ka procesuar gjithsej **525** lëndë, nga të cilat **408** raste janë hapur sipas detyrës zyrtare (ex-officio), ndërsa **117** raste tjera me kërkesën e palëve.
Nga gjithsej këto lëndë të procesuara:
 - **32** lëndë janë hapje të rastit për Kontrata të Dhënies me Qira të banesave;
 - **17** lëndë janë hapje të rastit për Kontrata për shfrytësimin e hapësirës publike për vendosjen e kiosqeve dhe objekteve tjera të përkohshme;
 - **359** janë hapje të rastit për marrje të lejes për vendosje të Panove Reklamuese;
 - si dhe lëndë të tjera siç janë këmbim prone, shpronësim, ankesa për uzurpim të Pronës, etj.
- Gjatë gjashtë (6) mujorit të parë të vitit 2026 jemi marrë me lëndë të natyrave të ndryshme, duke përfshirë lëndët për shpronësim, këmbime të pronës së paluajtshme, dhënie të lejes për shfrytëzim të përkohshëm të pronës publike, evidentimin dhe parandalimin e uzurpimit si dhe largimin e uzurpimeve nga pronat komunale;

- Në qytet janë realizuar 9(nëntë) rrëtime të objekteve të përkohshme,për interes të përgjithshëm publik,për mundësimin e formimit të rrugëve.
- Zhvillimin e procedurave për rrëtimin e disa objekteve të përkohshme të cilat nuk posedojnë leje.

Të hyrat e gjeneruara nga Drejtoria për Çështje Pronësore-Juridike:

- Nga pagesat e panove reklamuese deri me datë 30.06.2026 kemi gjeneruar të hyra në vlerë prej **103,383,25 €**.
- Nga pagesa e qirasë nga objektet publike të cilat janë në shfrytëzim, deri me datë 30.06.2026 - kemi gjeneruar të hyra në vlerë prej **11,042.5 €**.
- Nga shitja e pasurisë janë gjeneruar të hyra në shumën prej **700.00€**.
- Nga dhënia në shfrytëzim e pronës publike (Kioska, Objekte të përkohshme) Drejtoria për Çështje Pronësore–Juridike deri me date 30.06.2026 ka gjeneruar të hyra në vlerë prej **145153.00 €**.
- **Në total, nga data 03.01.2026 deri më 30.06.2026, Drejtoria për Çështje Pronësore-Juridike ka gjeneruar të hyra në vlerë prej 260,288,78 €.**

RAPORT I AKTIVITETEVE TË REALIZUARA NGA INSTITUCIONET E DKRS NË 2025

D.K.R.S

Nr	Emri i Aktivitetit	Përshkrimi i aktivitetit (deri 300 karaktere)	Data e realizimit të	Kush i mbuloj shpenzimet
1	Shpallja e Sportistit të Vitit	Me qëllim të motivimit dhe vlerësimit të sportistëve më të suksesshëm dhe klubeve sportive që kanë shënuar rezultate të larta, është organizuar ceremonia madhështore "Sportisti i Vitit 2024". Në këtë ngjarje u vlerësuan arritjet individuale dhe kolektive, duke theksuar rolin e sportit në promovimin e një jete aktive dhe të shëndetshme.	15 Janar	
2	Mbështetja me Subvencione për Organizatat Kulturore, Rinore dhe Klubet Sportive	Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport ka shpallur thirrjen për mbështetje me subvencione me anë të projekt propozimeve për organizatat kulturore, rinore dhe klubet sportive, duke vënë në dispozicion një fond prej 350,000 euro, nga i cili kanë përfituar mbi 60 organizata kulturore, rinore dhe klube sportive të qytetit tonë.	3 Shkurt - 10 Mars	
3	Aktivitetet për Ditën e Pavarësisë	Në shënim të Ditës së Pavarësisë, u organizuan ekspozita artistike, koncerte argëtuese dhe aktivitete të tjera kulturore.	17 Shkurt	
4	Crossi 2026 – Aktivitet Sportiv për Ditën e Fëmijëve	Me rastin e 1 Qershorit, u mbajt Crossi 2026 ku morën pjesë fëmijë nga shkollat fillore dhe të mesme të komunës së Pejës, duke promovuar jetesën aktive dhe sportin që në moshë të hershme.	1 Qershor	
5	Aktivitetet për Ditën e Çlirimit të Pejës	Dita e Çlirimit të qytetit u shënuar me një varg aktivitetesh. Në kuadër të këtij manifestimi, u organizua ceremonia solemne për ndarjen e çmimeve të nderit, duke vlerësuar personalitetet dhe kontribuesit më të shquar të jetës kulturore, ekonomike dhe shoqërore të komunës së Pejës.	16 Qershor	
6	Mbrëmja Kulturore në Shënim të 250-vjetorit të Demokracisë Amerikane	Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport organizoi një mbrëmje kulturore në Pejë në shënim të 250-vjetorit të demokracisë amerikane, duke promovuar vlerat e lirisë, demokracisë dhe miqësisë së qëndrueshme ndërmjet Kosovës dhe SHBA-ve.	Korrik 2025	
7	Aktivitete Përkujtimore për 31-vjetorin e Gjenocidit në Srebrenicë	Me mbështetjen e Komunës së Pejës u organizuan aktivitete kulturore-edukative dhe Marshi i Paqes për Srebrenicën, në nderim të viktimave të gjenocidit dhe për promovimin e paqes, solidaritetit dhe kujtesës historike.	11 Korrik 2025	
Muzeu i Pejës				

Nr	Emri i Aktivitetit	Përshkrimi i aktivitetit (deri 300 karaktere)	Data e realizimit të aktivitetit	Kush i mbuloi shpenzimet
1	Festojmë Ditën e Pavarësisë së Republikës së Kosovës	Për nder të shënimit të Ditës së Pavarësisë së Republikës së Kosovës, Muzeu i Pejës ka mirëpritur nxënës të shkollave fillore ku, përveç njohjes së tyre me trashëgiminë kulturore, është diskutuar edhe për rëndësinë e trashëgishënimisë kulturore dhe të Ditë së Pavarësisë. <i>Nvënësit janë të shkollave si në vijim: SHEMLI 'Ali Kelmendi' nga Naberciani / Kl. I</i>	12.02.2026 13.02.2026 16.02.2026	Pa kosto
2	Dita Ndërkombëtare e Monumenteve dhe Siteve Arkeologjike	Dita Ndërkombëtare e Monumenteve dhe Siteve Arkeologjike në Muzeun e Pejës u shënua me një orë mësimi nga lënda e historisë me nxënësit e gjimnazit 'Bedri Pejani', të shoqëruar nga prof. Driton Selimaj, ku u diskutua rreth trashëgimisë kulturore të Rafshit të Dukagjinit, në përgjithësi, dhe për lahutën, në veçanti.	17.04.2026	Pa kosto
3	Dita Ndërkombëtare e Muzeut	'Dita Ndërkombëtare e Muzeut' në Muzeun e Pejës u shënua me prezentimin e 'heshtës' (maje shigjete), artefakt i gjetur në oborrin e familjes së Ramadan Haxhujajt nga fshati Raushiq, i dhuruar nga e njeja familje. Në këtë aktivitet, përveç pjesmarrësve tjerë, kanë marr pjesë edhe <i>familjarët/dhuruesit e familjes Haxhijai si dhe nxënësit e SHEMLI 'Asdreni' nga</i>	18.05.2026	Pa kosto
4	Dita e Çlirimit të Pejës	Në kuadër të aktiviteteve të Komunës së Pejës për shënimin e Ditës së Çlirimit të Pejës, Muzeu i Pejës, në bashkëpunim me DKRS, ka qëndruar i hapur për vizitorë. Gjatë kësaj Dite, Muzeun e kanë vizituar vizitorë vendorë, të huaj si dhe nga diaspora.	16.06.2026	Pa kosto

Biblioteka "Azem Shkreli" në Pejë

Nr	Emri i Aktivitetit	Përshkrimi i aktivitetit (deri 300 karaktere)	Data e realizimit të aktivitetit	Kush i mbuloj shpenzimet
1	Libri – Urë lidhëse mes kulturave	Në Bibliotekën “Azem Shkreli” u zhvillua aktiviteti i pranim-dorëzimit të 13 paketave me libra shkencorë për mësimin e gjuhës turke, donacion nga Türk Dil Kurumu. Aktiviteti u realizua në kuadër të promovimit të kulturës së leximit dhe bashkëpunimit kulturor.	05.01.2026	Türk Dil Kurumu Në vlerë prej 6000 €
2	3 biblioteka – Një qëllim	Biblioteka “Azem Shkreli”, në bashkëpunim me organizatën The Library Kosovo dhe bibliotekat partnere, ka aplikuar në MKRS për subvencionim të projektit “3 biblioteka – Një qëllim”, me synim promovimin e leximit, fuqizimin e bashkëpunimit bibliotekar dhe zhvillimin e aktiviteteve kulturore. Nga Organizata jo qeveritare The Library Kosovo u realizua pranim-dorëzimi i librave 6 tituj me 186 ekzemplarë librash në vlerë prej 1,027 euro.	12.01.2026	MKRS Në vlerë prej 1027 €

3	Biblioteka Qarkulluese – Lexim dhe aktivitet krijues me tregimin “Ylberi – Peshku më i bukur në oqean”	Në bashkëpunim me SHFMU “Asdreni”, nxënësit e klasës së tretë zhvilluan aktivitet leximi dhe diskutimi mbi empatinë, miqësinë dhe bashkëpunimin, si dhe shprehën kreativitetin përmes vizatimit dhe artit.	29.01.2026	3 € Shengyl Kelmendi Gashi Drejtoresha e Bibliotekës
4	Nënshkrimi i Memorandumit të Bashkëpunimit me shkollën Qendra për Karrierë IAAP 'Rifat Gjota'- Pejë	Biblioteka “Azem Shkreli” dhe shkolla partnere nënshkruan Memorandum Bashkëpunimi për forcimin e bashkëpunimit institucional dhe promovimin e leximit te nxënësit përmes aktiviteteve të përbashkëta edukative dhe kulturore.	26.01.2026	Pa kosto
5	“Dialog me Azem Shkrelin” – Ditë kushtuar kujtesës letrare	Aktivitet kulturor i organizuar nga Biblioteka “Azem Shkreli”, i mbajtur në Qendrën Kreative Dukagjini, me rastin e 88-vjetorit të lindjes së poetit. Nxënësit e SHFMU “28 Nëntori” prezantuan dramë dhe reflektime letrare.	10.02.2026	Rolbaneri "Dialog me Azem Shkrelin" I paguar nga DKRS - ja.
6	“Letër për Kosovën” – Aktivitet letrar për 18-vjetorin e Pavarësisë	Biblioteka “Azem Shkreli”, në bashkëpunim me IAAP “Rifat Gjota”, organizoi aktivitet letrar për 18-vjetorin e Pavarësisë së Kosova. Nxënësit prezantuan letra tematike, ndërsa 6 nxënës u shpërblyen me mirënjohje dhe libra.	13.02.2026	Mirënohjet e punuara nga DKRS- ja
7	Shënimi i Ditës Ndërkombëtare të Gjuhës Amtare	Biblioteka “Azem Shkreli”, në bashkëpunim me SHFMU “Smajl Hajdaraj”, organizoi aktivitet me ese, poezi dhe dialog me krijues vendorë për rëndësinë e gjuhës amtare. U realizua edhe “Muri Simbolik i Fjalës” me mesazhe nga nxënësit.	21.02.2026	Pa kosto “Biblioteka ‘Azem Shkreli’ dhe SHFMU ‘Smajl Hajdaraj’ (pa kosto shtesë)
8	Biblioteka Qarkulluese në Veprim	Nxënësit e klasës 3/1 u regjistruan në bibliotekë, huazuan librin “Unë jam milingonë” dhe morën pjesë në një orë leximi dhe diskutimi mbi botën e milingonave dhe vlerat e bashkëpunimit.	18.03.2026	Pa kosto
9	Zbulimi i Yjeve të Poezisë	Festë letrare për Ditën Ndërkombëtare të Poezisë me pjesëmarrje nxënësish të talentuar, ku u ndanë çmime për krijimtarinë dhe interpretimin artistik. Fituesit e çmimeve u përzgjedhën nga një juri profesionale, e përbërë nga: Nagjije Berbat i Kastrati, Riza Dreshaj dhe Arbnesha Kelmendi Draga, të cilët vlerësuan me përkushtim kreativitetin, origjinalitetin dhe interpretimin artistik. “Ylli i Artë i Poezisë” – Leona Asllani (Shkolla e Mesme e Mjekësisë) “Fjala e Ndritur” – Larisa Gashi (SH.F.M.U “Fan S. Noli”)	23.03.2026	Mirënohjet e punuara nga DKRS- ja dhe nga Biblioteka "Azem Shkreli" është dhuruar libra fituesve .
10	Dhurim librash nga Havë Shabanaj	Biblioteka u pasurua me dy tituj të rinj "Rrugëtimi i Refugjatit" dhe "A Refugee's Journey" falë dhuratës së autorës Havë Shabanaj, duke kontribuar në fondin librar dhe promovimin e leximit.	24.03.2026	Havë Shabanaj në vlerë prej 70 €
11	Promovimi i librit “Shtegtim ndjenjash”	Promovim i librit të autores së re Leona Asllani me fjalë vlerësuese nga redaktori, lektorja, profesori dhe recitime të poezive nga shoqet e klasës së autores.	01.04.2026	Pa kosto

12	Vizita e nxënësve të Shkolla Fillore "Rilindja"	Nxënësit vizituan bibliotekën, u njohën me fondin librar dhe rëndësinë e leximit. Lexuan përralla dhe u informuan për regjistrimin falas në bibliotekë.	02.04.2026	Pa kosto
13	Program artistik për Ditën Ndërkombëtare të Librit për Fëmijë	Nxënësit e klasave I–V nga Shkolla Fillore "Haxhi Zeka" performuan poezi, recital, dramë dhe muzikë, duke promovuar librin dhe talentin e tyre.	02.04.2026	SHFMU "Haxhi Zeka" nga familjarët e fëmijëve është mbledhur fondi për tu realizuar ky projekt program artistik për ditën Nderkombetare të Librit për Fëmijë në vlerë prej
14	Qytetari Digjital (Punëtori / trajnime praktike në grup)	Punëtoritë edukative për fëmijë dhe të rinj mbi përdorimin dhe programimin e pajisjeve teknologjike (Micro:bit, Robota edukativë, 3D Printer). Synon nxitjen e shkathtësive digjitale dhe mendimit kritik. 27 nxënës morën pjesë.	03.01.2026 - 30.06.2026	Pa kosto
15	Vizitë edukative e fëmijëve nga Kopshti "Engjujt"	Të nxitet dashuria për librin dhe të prezantohet biblioteka si hapësirë edukimi dhe imagjinate për fëmijët. Fëmijët u njohën me ambientet dhe shërbimet e bibliotekës, dëgjuan me interes një tregim dhe morën pjesë në aktivitete kreative, duke shprehur imagjinatën dhe mendimet e tyre. Vizita krijoi një përvojë të bukur dhe frymëzuese, duke forcuar interesimin e fëmijëve për leximin dhe bashkëpunimin me Kopshtin "Engjujt".	16.04.2026	Pa kosto
16	Dhurojmë libra – Ndërtojmë të ardhmen	Të shënohet Dita Botërore e Librit dhe e Drejtës së Autorit, të promovohet kultura e leximit, të pasurohet fondi bibliotekar dhe të forcohet bashkëpunimi me institucionet arsimore dhe partnerët. Biblioteka pranoi donacion librash nga Shtëpia Botuese "Dukagjini", duke pasuruar fondin bibliotekar. Nxënësit e SHFMU "Lidhja e Prizrenit" dhe "Haxhi Zeka" realizuan program artistik dhe përcollën mesazhe për rëndësinë e librit dhe leximit, duke promovuar kulturën e leximit në komunitet. Aktiviteti kontribuoi në pasurimin e fondit librar në vlerë prej 1170 €, rriti ndërgjegjësimin për rëndësinë e librit dhe forcoi bashkëpunimin ndërmjet bibliotekës, shtëpisë botuese dhe shkollave, duke nxitur leximin si vlerë të rëndësishme kulturore dhe edukative.	23.04.2026	Shtëpia Botuese "Dukagjini" Në vlerë prej 1170 €
17	Dita Botërore e Librit dhe e drejta e autorsisë	Të shënohet Dita Botërore e Librit dhe e Drejtës së Autorit, duke nxitur dashurinë për leximin tek fëmijët, promovuar bibliotekën si qendër edukimi dhe zhvilluar kreativitetin përmes aktiviteteve letrare. Fëmijët e Grupit "Dielli" u njohën me ambientet dhe fondin librar të bibliotekës, dëgjuan tregime, morën pjesë në aktivitete kreative dhe shfaqën interes e entuziazëm për librin dhe leximin. Aktiviteti krijoi një përvojë të këndshme dhe edukative për fëmijët, forcoi lidhjen e tyre me bibliotekën dhe promovoi leximin si një vlerë të rëndësishme për zhvillimin e imagjinatës, dijes dhe kulturës së leximit.	23.04.2026	Pa kosto
18	Vizitë edukative e çerdhës "Pëllumbat e Paqës" në kuadër të Ditës Botërore të Librit	Të shënohet Dita Botërore e Librit dhe e Drejtës së Autorit, duke nxitur dashurinë për librin dhe leximin që në moshë të hershme, si dhe duke prezantuar bibliotekën si një hapësirë edukative dhe kulturore për fëmijët. Fëmijët u njohën me ambientet dhe shërbimet e bibliotekës, dëgjuan tregime, morën pjesë në aktivitete edukative dhe kreative dhe shfaqën interes të madh për librat dhe botën e leximit. Vizita kontribuoi në zhvillimin e kulturës së leximit të fëmijët, forcoi bashkëpunimin ndërmjet Bibliotekës "Azem Shkrel" dhe çerdhës "Pëllumbat e Paqës" dhe promovoi bibliotekën si një qendër të rëndësishme për edukimin dhe zhvillimin kulturor të brezave të rinj.	23.04.2026	Pa kosto

19	Vizitë edukative e nxënësve të SHFMU “Ramiz Sadiku” në kuadër të Ditës Botërore të Librit	Te shenohet Dita Botërore e Librit dhe e Drejtës së Autorit, duke promovuar kulturën e leximit, rëndësinë e librit në zhvillimin intelektual dhe shpirtëror të fëmijëve, si dhe duke afruar nxënësit me bibliotekën. Nxënësit e klasave të katërta u njohën me ambientet dhe shërbimet e bibliotekës, morën pjesë në lexim dhe bashkëbisedim mbi librat e tyre të preferuar, duke shfaqur interes, kureshtje dhe pjesëmarrje Aktiviteti kontribui në forcimin e kulturës së leximit, rriti ndërgjegjësimin për vlerën e librit si burim i dijes dhe forcoi bashkëpunimin ndërmjet Bibliotekës “Azem Shkreli” dhe SHFMU “Ramiz Sadiku”, duke inkurajuar fëmijët të jenë lexues të rregullt dhe përdorues aktivë të bibliotekës.	23.04.2026	Pa kosto
20	Promovimi i librit “Rrezja e plagosur”	Të promovohet krijimtaria letrare e autorëve të rinj, të afirmohen vlerat kulturore dhe historike, si dhe të inkurajohet leximi dhe pjesëmarrja e komunitetit në aktivitete letrare. U promovua libri “Rrezja e plagosur” i autores Njomza Kelmendi, me pjesëmarrjen e dashamirëve të librit, familjarëve dhe mysafirëve. Aktiviteti u pasurua me fjalë vlerësuese nga personalitete të fushave të ndryshme, interpretime artistike dhe muzikore, duke promovuar veprën dhe vlerat që ajo përcjell. Në fund të promovimit të librit pati koktej rasti me ushqim tradicional. Promovimi forcoi rolin e Bibliotekës “Azem Shkreli” si qendër e jetës kulturore, mbështeti autorët e rinj dhe kontribui në promovimin e letërsisë, kujtesës historike dhe kulturës së leximit në komunitet.	04.05.2026	Familja e Njomza Kelmendit
21	Biblioteka Qarkulluese – Përdorimi i Fjalorit të Gjuhës Shqipe	Të zhvillohen shprehitë e leximit, të pasurohet fjalori i nxënësve dhe të aftësohen ata në përdorimin e Fjalorit të Gjuhës Shqipe për të kuptuar fjalët e panjohura, përmes metodave interaktive dhe punës në grup. Nxënësit e SHFMU “Asdreni”, pas leximit të librit “Uta e maleve”, punuan në grupe dhe përdorën Fjalorin e Gjuhës Shqipe për të gjetur kuptimin e fjalëve të panjohura. Aktiviteti u zhvillua në formë gare edukative, duke nxitur bashkëpunimin, të menduarit kritik dhe përdorimin praktik të burimeve referuese. Në përfundim, secili nxënës mori në huazim librin “Nelly Rapp dhe academia e përbindëshave”. Aktiviteti forcoi kulturën e leximit, pasuroi fjalorin e nxënësve, zhvilloi aftësitë e kërkimit në fjalor dhe i motivoi ata të vazhdojnë leximin përmes projektit “Biblioteka Qarkulluese”, duke e bërë bibliotekën një hapësirë aktive të mësimi dhe zhvillimit.	06.05.2026	Pa kosto
22	Punëtori kreative me Bonovet – “Lexo, Mendo dhe Krijo”	Të promovohet leximi, mendimi kritik dhe kreativiteti të fëmijët, duke kombinuar aktivitetet me librin dhe përdorimin e teknologjisë përmes programimit dhe robotikës. Tetë fëmijë nga klasa “Lexo, Mendo dhe Krijo” e Bonovet u njohën me ambientet dhe shërbimet e bibliotekës, morën pjesë në aktivitete kreative dhe provuan programimin praktik me robotin Maqueen përmes platformës Mind+, duke zhvilluar aftësi në lexim, logjikë, bashkëpunim dhe teknologji. Aktiviteti dëshmoi se ndërthurja e librit me teknologjinë krijon një përvojë	26.05.2026	:Pa kosto
23	“Balonat Magjike të Librave” – Shënimi i 1 Qershorit, Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve	Te shenohet Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve përmes një aktiviteti edukativ dhe argëtues që promovon dashurinë për librin, zhvillon kulturën e leximit dhe forcon lidhjen e fëmijëve me bibliotekën. Nxënësit e klasës së mësueses Granita Merxha nga SHFMU “Lidhja e Prizrenit” morën pjesë në lojën edukative “Balonat Magjike të Librave”, ku demonstruan njohuritë dhe kreativitetin e tyre përmes pyetjeve rreth librave dhe personazheve letrare. Në përfundim të aktivitetit, në kuadër të projektit “Biblioteka Qarkulluese”, secili nxënës huazoi librin “Uta e Maleve” të autores Tefta Kelmendi. Aktiviteti krijoi një atmosferë festive dhe edukative, duke nxitur leximin përmes lojës, bashkëpunimit dhe pjesëmarrjes aktive. Ai forcoi interesimin e fëmijëve për librin dhe bibliotekën, duke promovuar bibliotekën si një hapësirë ku fëmijët mësojnë, krijojnë dhe argëtohen.	01.06.2026	Shengyl Kelmendi Gashi në vlerë prej 10 €

24	Prezantimi i projektit “Mbrotja e Mjedisit” nga nxënësit e SHFMU “Lidhja e Prizrenit”	Të promovohet edukimi mjedisor, të inkurajohet hulumtimi dhe puna në grup, si dhe të forcohet roli i bibliotekës si mbështetëse e proceseve mësimore dhe projekteve edukative. Nxënësit e klasës VII/1 të SHFMU “Lidhja e Prizrenit”, nën udhëheqjen e kujdestares Flora Katanolli, prezantuan projektin e tyre mbi mbrojtjen e mjedisit. Përmes punës hulumtuese dhe prezantimeve kreative, ata dëshmuuan njohuri, përgjegjësi dhe vetëdije për rëndësinë e ruajtjes së natyrës dhe mjedisit. Aktiviteti forcoi bashkëpunimin ndërmjet bibliotekës dhe shkollës, zhvilloi kulturën e hulumtimit dhe ndërgjegjësoi nxënësit për mbrojtjen e mjedisit, duke e afirmuar bibliotekën si një qendër të rëndësishme edukative dhe kulturore për komunitetin.	02.06.2026	Shengyl Kelmendi Gashi në vlerë prej 5 €
25	“Kush jam unë?” – Aktivitet edukativo-argëtues me nxënësit e SHFMU “Skënder Çeku”	Të promovohet kultura e leximit, njohja me personalitetet e letërsisë, artit dhe muzikës, si dhe të zhvillohen të menduarit kritik, komunikimi dhe bashkëpunimi përmes lojërave edukative. Nxënësit e SHFMU “Skënder Çeku” morën pjesë në aktivitetin interaktiv “Kush jam unë?”, ku përmes pyetjeve dhe lojës identifikuan shkrimtarë, artistë dhe këngëtarë të njohur. Ata treguan njohuri, kreativitet, bashkëpunim dhe pjesëmarrje aktive gjatë gjithë aktivitetit. Aktiviteti forcoi lidhjen e nxënësve me bibliotekën, nxiti interesimin për librin, kulturën dhe artin, si dhe e promovoi bibliotekën si një hapësirë bashkëkohore për mësim, argëtim dhe zhvillim të aftësive të fëmijëve.	11.06.2026	Pa kosto
26	Pranim donacioni librash nga shkrimtari dhe profesori Pren Buzhala	Të pasurohet fondi bibliotekar me botime të reja, të promovohet kultura e dhurimit të librit dhe të forcohet bashkëpunimi me autorët dhe krijuesit vendorë. Biblioteka “Azem Shkreli” pranoi donacion prej 9 titujsh me 21 ekzemplarë, në vlerë prej 180 euro, të dhuruara nga shkrimtari dhe profesori Pren Buzhala. Librat pasuruan fondin bibliotekar me vepra me vlera letrare dhe studimore. Në shenjë mirënjohjeje për kontributin e tij, bibliotekës iu dha një mirënjohje donatorit. Ky donacion kontribuoi në zgjerimin e fondit librar dhe në përmirësimin e shërbimeve për lexuesit, duke forcuar bashkëpunimin ndërmjet Bibliotekës “Azem Shkreli” dhe autorëve vendorë, si dhe duke promovuar kulturën e leximit dhe të dhurimit të librit në komunitet.	03.06.2026	Autori Brend Buzhala në vlerë prej 180 €.
27	Pranim donacioni i librit “Letërsia në shkollë – Interpretimi i letërsisë në shkollë të mesme të lartë”	Të pasurohet fondi bibliotekar me literaturë profesionale dhe studimore, të mbështetet procesi mësimor dhe të forcohet bashkëpunimi me autorët vendorë në promovimin e dijes dhe kulturës. Biblioteka “Azem Shkreli” pranoi si donacion librin “Letërsia në shkollë – Interpretimi i letërsisë në shkollë të mesme të lartë” nga autorja Nagjie Berbat-Kastrati, në vlerë prej 30 euro. Botimi pasuroi fondin bibliotekar me një vepër me rëndësi për nxënësit, studentët, mësimdhënësit dhe studiuesit e letërsisë. Donacioni kontribuoi në zgjerimin e fondit të literaturës profesionale të bibliotekës dhe në përmirësimin e shërbimeve për përdoruesit, duke mbështetur studimin, hulumtimin dhe promovimin e letërsisë shqipe.	16.06.2026	Autori I librit 30 €.
28	Pjesëmarrje në promovimin e librit “Letërsia në shkollë – Interpretimi i letërsisë në shkollë të mesme të lartë” dhe dhurimi i librave për Bibliotekën .	Përfaqësimi i Bibliotekës “Azem Shkreli” në aktivitete kulturore, të mbështetet promovimin i krijimtarisë shkencore dhe letrare, si dhe të forcohet bashkëpunimi me autorët dhe institucionet kulturore. Përfaqësuesit e Bibliotekës “Azem Shkreli” morën pjesë në promovimin e librit Letërsia në shkollë – Interpretimi i letërsisë në shkollë të mesme të lartë” të autores Nagjie Berbat-Kastrati. Gjatë aktivitetit u prezantuan vlerat profesionale dhe shkencore të veprës, ndërsa u krijuan mundësi për bashkëpunim të mëtejshëm në promovimin e librit dhe kulturës së leximit. Gjithashtu Biblioteka është pasuruar me këtë titull të librit. Pjesëmarrja në këtë promovim forcoi rolin e Bibliotekës “Azem Shkreli” si institucion aktiv në jetën kulturore të qytetit, duke mbështetur autorët vendorë dhe duke promovuar librin, dijen dhe zhvillimin e kulturës së leximit në komunitet gjithashtu pasurimi i fondit të bibliotekës me koleksione te reja.	03.06.2026	Pa kosto

29	“Kutia Magjike e Utës” – Aktivitet letrar në kuadër të projektit “Biblioteka Qarkulluese”	Të zhvillohet kultura e leximit, të përmirësohet të kuptuarit e tekstit letrar dhe të nxiten të menduarit kritik, komunikimi dhe kreativiteti i nxënësve përmes metodave interaktive të të nxënësve. Nxënësit e klasës së tretë të SHFMU “Lidhja e Prizrenit”, pasi lexuan librin “Uta e Maleve”, morën pjesë në aktivitetin interaktiv “Kutia Magjike e Utës”, ku iu përgjigjën pyetjeve rreth përmbajtjes së librit, analizuan personazhet dhe mesazhet kryesore, duke dëshmuar kuptim të mirë të leximit, bashkëpunim dhe pjesëmarrje aktive. Aktiviteti e shndërroi leximin në një përvojë argëtuese dhe edukative, forcoi shprehitë e të lexuarit me kuptim dhe të shprehurit, si dhe rriti motivimin e nxënësve për të vazhduar leximin në kuadër të projektit “Biblioteka Qarkulluese”, duke forcuar bashkëpunimin ndërmjet Bibliotekës “Azem Shkreli” dhe SHFMU “Lidhja e Prizrenit”.	17.06.2026	Pa kosto
Teatri Istref Begolli				
Nr	Emri i Aktivitetit	Përshkrimi i aktivitetit (deri 300 karaktere)	Data e realizimit të	Kush i mbuloj shpenzimet
1	17 Shkurti, Dita e Pavarësisë së Kosovës	Interpretim skenik	17.02.2026	K.K.Pejë
2	Audicion IAAP “Ali Hadri”	Projekti kulturor-edukativ “Festivali i Monologjeve për shkollat e mesme të larta – Monologu im”	29.04.2026	
3	Audicion SHML e Arteve Aplikative “Odhise Paskali”	Projekti kulturor-edukativ “Festivali i Monologjeve për shkollat e mesme të larta – Monologu im”	30.04.2026	
4	Audicion IAAP “Rifat Gjota”	Projekti kulturor-edukativ “Festivali i Monologjeve për shkollat e mesme të larta – Monologu im”	06.05.2026	
5	Audicion Gjimnazi “Cambridge”	Projekti kulturor-edukativ “Festivali i Monologjeve për shkollat e mesme të larta – Monologu im”	07.05.2026	
6	Audicion Gjimnazi “Bedri Pejani”	Projekti kulturor-edukativ “Festivali i Monologjeve për shkollat e mesme të larta – Monologu im”	08.05.2026	
7	Audicion SHML e Mjekësisë	Projekti kulturor-edukativ “Festivali i Monologjeve për shkollat e mesme të larta – Monologu im”	13.05.2026	
8	Audicion Gjimnazi “Cambridge”	Projekti kulturor-edukativ “Festivali i Monologjeve për shkollat e mesme të larta – Monologu im”	15.05.2026	



Republika e Kosovës

Republika Kosova

Republic of Kosovo



Komuna e Pejës

Opština Peć

Peja Municipality

Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër /Direkcija za Geodezija i Kataster /Department of Geodesis and Cadastre

PËR/ZA/TO:	z.Gazmend Muhaxheri, Kryetar i Komunës Pejës
PËRMES/PREKO/THROUGH:	z.Mustafë Nila, Drejtor i Drejtoratit për Gjeodezi dhe Kadastër
NGA/OD/FROM:	znj.Fjolla Kasapolli, UD si Shefi i Sherbimit Juridik-Administrativ
LËNDA:	Raporti i punës për periudhën 05.01.2026 - 30.06.2026.
Data:/Datum:/Date:	10.06.2026.

Nr.	EMËRTIMI I LËNDËS	Numri i lëndëve
1	NUMRI I KËRKESAVE PËR DALJE NË TERREN	22
	NUMRI I LËNDEVE TË REALIZUARA	22
	NUMRI I LËNDEVE TË PAREALIZUARA	0
2	NUMRI I LËNDËVE NGA GJEODETAT PRIVAT	416
	NUMRI I LËNDEVE TË REALIZUARA	412
	NUMRI I LËNDEVE TË PAREALIZUARA	4
3	NUMRI I LËNDËVE PËR BARTJE TË PRONËS	1364
	NUMRI I LËNDËVE TË REALIZUARA	1244
	NUMRI I LËNDËVE TË PAREALIZUARA	120
4	NUMRI I LËNDËVE PËR HISTORIAT TË PRONËS	83
	NUMRI I LËNDËVE TË REALIZUARA	83
	NUMRI I LËNDËVE TË PAREALIZUARA	0
5	NUMRI I LËNDËVE PËR REGJISTRIM/FSHIRJE TË HIPOTEKAVE	255
	NUMRI I LËNDËVE TË REALIZUARA	246
	NUMRI I LËNDËVE TË PAREALIZUARA	9
6	NUMRI I LËNDËVE PËR LEGALIZIM	52
	NUMRI I LËNDËVE TË REALIZUARA	48
	NUMRI I LËNDËVE TË PAREALIZUARA	4

7	NUMRI I LËNDËVE PËR KORRIGJIM TË DHËNAVE	35
	NUMRI I LËNDËVE TË REALIZUARA	28
	NUMRI I LËNDËVE TË PAREALIZUARA	7
8	NUMRI I KËRKESAVE PËR FLETA POSEDUESE DHE KOPJE TË PLANIT	3454

Raport Gjashtëmuor i Punës

Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim - Komuna Pejës
Periudha Janar - Qeshor 2026

Gjatë periudhës gjashtëmuore, Drejtoria ka realizuar aktivitet e saj në menaxhimin e situatave emergjente, parandalimin e rreziqeve dhe koordinimin ndërinstitutional.

Aktivitet kryesore:

- Hartimi raporteve, planeve operative dhe kordinimi i vazhdueshëm me institucionet përgjegjëse.
- Menaxhimi dhe kordinimi i rasteve të zjarreve në territorin e Komunës së Pejës.
- Reagimin në raste emergjente, përfshirë bllokimin e nje familje nga bora në rrugën Kullë - Rozhaj dhe ndërhyrje tjera për shpëtim.
- Organizimi i takimeve kordinuese me Policinë e Kosovës, Komandantin e zjarrfikësve, pylltarët dhe kryetaret e bashkësive lokale për parandalimin e zjarreve.
- Realizimi i ligjëratave sensibilizuese në bashkëpunim më 112-shin në shkollën Vaso Pash Shkodrani Pejë, Shkolla Dardania Pejë dhe Shkolla 28 Nëntori në Raushiq.
- Pjesëmarrja në ushtrime dhe trajnime dhe takime profesionale në fushën e mbrojtjes dhe shpëtimit.
- Janë realizuar inspektime për kontrollimin e pajisjeve kundër zjarrit.
- Perfundimi i raportit për vlersimin e damave ndaj fatkeqësive natyrore.

Rastet e Zjarrit:

- Janë evidentuar **127** raste zjarri

Aksidente në Trafik.

- Janë realizuar **7 raste** në aksidente trafiku.
- Si pasojë e aksidenteve janë evidentuar **5 persona** të lënduar
- Në aksidentin e trafikut të ndodhur në fshatin Loxhë, një qytetare humbi jetën më initiale **A.Kastrati**, njësia jonë intervenoi në vendin e ngjarjes.

PËRFUNDIM

Gjatë periudhës janar - qeshor 2026, Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim ka realizuar detyrat dhe përgjegjësitë e saj me përkushtim dhe profesionalizëm.

Angazhimi ynë do të vazhdojë edhe në të ardhmen, me synim rritjen e sigurisë dhe mbrojtjen e qytetarëve të Komunës së Pejës.

Luan Vocaj

Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS * MUNICIPALITY OF PEJA * OPŠTINA PEĆ
DREJTORIA PËR MIRËQENIE SOCIALE
Directorate of Social Welfare
Direktorijat za Socijalnu Zaštitu

Raport i Punës Janar-Qershor '2026

Pejë,

REFERENCA :	Raport i Punës
Datë/Datum/Date	Qershor 2026
PËR/ZA/TO	Z. Gazmend Muhaxheri - Kryetar i Komunës së Pejës
PËRMES/PREKO/THROUGH	Albulena Mujaj Bajraktaraj - Drejtoreshë e Mirëqenies Sociale
NGA/OD/FROM	Drejtoria Për Mirëqenie Sociale-Pejë
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT	RAPORTI I PUNËS / JANAR – QERSHOR 2026

RAPORT I PUNËS JANAR - QERSHOR ‘2026

Gjatë kësaj periudhe raportuese Drejtoria për Mirëqenie Sociale ka realizuar aktivitetet e listuara si më poshtë:

AKTIVITETET E DREJTORISË

- Është hapur thirrja publike për subvencionimin e OJQ-ve me karakter social , nga e cila thirrje Komisioni Vlerësues ka vlerësuar projektet te cilat i kane plotësuar kriteret e thirrjes.
Nga kjo thirrje janë përkrahur gjithsejtë dhjetë (10) OJQ me karakter social:
- **Duart plote Mëshirë** - “ Mbështetje Shëndetësore e Sociale për Komunitetin”
- **Qendra për Mirëqenien e Gruas-Pejë** - “Shërbime rezidenciale dhe reintegruese për gra dhe fëmijë të mbijetuara të dhunës në familje”
- **Qendra për Jete te Pavarur** - “Ofrimi i shërbimeve sociale për personat me aftësi të kufizuara mendore ne Komunën e Pejës”
- **Qendra e Kujdesit Ditor Pema** - “Mbeshtetje e integruar dhe gjithëpërfshirëse për zhvillimin dhe mirëqenien e fëmijëve me aftësi të kufizuara”
- **Asociacioni te Semuarve nga Diabeti ne Peje-ASDP-** “Si te pergjigjemi nevojave gjithnje e ne rritje te menaxhimit te problemeve diabetike te qytetareve te komunes se Pejes me theks te vecante femijeve me diabet”
- **Handikos Pejë** - “Sherbime ditore dhe në familje për fëmijët dhe të rriturit me aftësi të kufizuara” ”
- **SHHBK “Nëna Terezë”** “Sherbime me karakter social-Perkujdesje për të moshuar”
- **OJQ “Princesha”** “Sherbime ditore te drejperdrejta dhe asistence materiale per personat e moshuar ne Komunen e Pejes”
- **OJQ për Fëmijët pa Kujdes Prindëror (OFAP)** –“Mbeshtetja dhe zhvillimi i sherbimit te strehimit familjar ne komune te Pejes.Fuqizimi i strehimit Familjar dhe mbështetjes psiko-sociale për fëmijet në nevojë në Komunën e Pejës”
- **Shoqata Nderkomunale e te Verberve-Pejë-** “Mbështetja për personat e verbër në Komunën e Pejës”
- Dyqind (200) familje me asistencë sociale janë ndihmuar me nga dy(2) metra lende drusore.

KRIJIMI I INFRASTRUKTURES SE RE

- Ndertimi (Adaptimi) i Objektit të Shtëpisë për Mbrojtjen e Fëmijëve.

RAPORT VJETOR I PUNËS SE QENDRES PER PUNE SOCIALE Janar-Qershor '2026

SHËRBIMI SOCIAL

Qendra për Punë Sociale në Pejë, gjegjësisht Sektori i Shërbimeve Sociale për gjatë mujorit të parë Janar-Qershor 2026 ka kryer punët dhe detyrat në kompetencat që i ka si Institucion, dhe është angazhuar në realizimin e detyrave dhe obligimeve që dalin nga Ligji i Shërbimeve Sociale dhe Familjare, Ligji mbi Familjen në Kosovë si dhe nga Legjislacioni në fuqi.

Shërbimi Social pranë Qendrës për Punë Sociale në Pejë për këtë periudhë kohore ka evidentuar në protokollin e Shërbimeve Sociale 599 shërbime, prej të cilave 223 janë dosje. Dosjet që janë kryer janë 200 dhe 23 janë në përpunim. Gjithashtu kemi 11 Certifikata për shlyerje të shtetësisë, 267 Certifikata për armë dhe 98 Certifikata për zotësi të veprimit (për punësim).

Bazuar në evidencën për lëndët e hapura e që kanë hyrë në përpunim, sipas kategorive të shërbimit social ju raportojmë në vazhdim:

- 1. Kërkesa për këshilla martesore:** Në këtë periudhë kohore kemi 0 kërkesa për këshillime martesore, Ndarje me padi 25, Ndarje me marrëveshje janë 8, Padi për besim të fëmijëve 2.
30 Lëndë janë përfunduar dhe Raportet janë dërguar në Gjykatë, ndërsa 5 Lëndë janë në Procedim.
- 2. Kontaktim mes prindit dhe fëmijës:** Në këtë periudhë kohore kemi 4 kërkesa për kontaktim. Në këtë lëmi kemi edhe 14 lëndë që janë aktive, ku realizohet kontaktimi në mes prindit dhe fëmijëve në lokalet e QPS.
- 3. Kërkesë për adoptim vendor:** Në këtë periudhë kohore nuk kemi pasur kërkesë për adoptim vendor as nderkombtare.

4. Fëmijët pa përkujdesje prindërore: Gjatë kësaj periudhe nuk kemi pranuar kërkesa.

5. Strehim për të moshuar: Në këtë periudhë kohore kemi pasur 2 kërkesa për strehim të moshuarve.

6. Trafikim: Nga kjo lami gjatë kësaj periudhe kohore nuk pasur ndonjë rast të referuar për ofrim të shërbimeve psiko-sociale.

7. Sjelljet asociale / delikuate: Në këtë periudhë kohore kemi 3 lëndë të fëmijëve me sjellje asociale dhe delikuate ku prej tyre 41 lëndë janë delikuate/kundërvajtje dhe 2 lëndë me sjellje asociale (braktisje nga shkolla). Nga këto kategori kemi edhe 7 lëndë që janë nën mbikëqyrje të Organit të Kujdestarisë në periudha kohore prej 6 muaj deri në 1 vit.

8. Dhuna familjare dhe ngacmimi seksual: Në këtë periudhë kohore kemi 28 raste të dhunës në familje dhe 1 ngacmim seksual. Aktive në këtë kategori kemi 20 lëndë ndërsa 8 kanë përfunduar, gjithashtu në këtë periudhë kemi edhe 15 Aktgjykime për urdhër mbrojtje të lëshuar nga Gjykata Themelore.

9. Kujdestaria e posaçme/përhershme: Në këtë periudhë kohore kemi 25 raste të caktimit dhe ndryshimit të kujdestareve për fëmijë dhe të moshuar. Në këtë kategori në kujdestari kemi 89 fëmijë dhe 11 raste të kujdestarisë të personat e rritur që të gjitha këto lëndë janë aktive.

10. Heqja e të drejtës prindërore: Në këtë periudhë kohore i kemi 2 raste njera ju është marre me vendim Gjykates ndërsa tjetra është ne procedure nga Gjykata për heqjen e të drejtës prindërore.

11. Heqja e zotësisë se veprimit: 8 Lëndë në procedurë për heqje të zotësisë se veprimit.

14. Konstatim të gjendjes faktike: Gjatë kësaj periudhe kohore, kemi 10 kërkesa për konstatim të gjendjes faktike, të 10 rasteve iu është ofruar shërbimi.

15. Pëlqim për martesë para moshës madhore: Në këtë periudhë kohore kemi pasur kërkesë për dhënie të mendimit për martesë para moshës madhore.

16. Vendosje në strehim familjar tek të afërmit: Në këtë periudhë kohore kemi pasur 2 kërkesa, të cilat janë proceduar me vendime dhe kontrata për pagesa mujore.

17. Vendosje në familje streuehese: Në këtë periudhë kemi pasur 2 raste ku i kemi vendosur 6 fëmijë.

18. Fëmijët me aftësi të kufizuar: Për këtë kategori në këtë periudhë kohore i kemi të regjistruara 28 Kërkesa (aplikacione). Nga këto kërkesa 28 i janë nënshtruar komisionit mjekësor 15aprovime, 4 refuzime, 3 plotësime , 6 lëndë janë të bartura nga viti 2025 nga këto 3 janë aprovuar 2 refuzime dhe 1 mungesë
Lëndë aktive me pagesë në bazë janë gjithsejtë 165.

17. Aktvendime, Njoftime, Kërkesa, Ankesa, Fletë lëshime nga Qendrat Korrektuese:

Në këtë periudhë kohore kemi pranuar gjithsej 13 kërkesa:

Aktvendime nga Gjykata: 30

Njoftime nga Gjykata / Prokurori: 20

Kërkesa nga Institucione të ndryshme: 2

Ankesa për shkallë të dytë për A.K: 2

Proces verbal A.K: 2

Fletë Lëshime nga Qendrat Korrektuese: 2

Në data bazën e përgjithshme gjithsejtë janë të bartura 6037 lëndë.

Sherbimi i Ndhimave Sociale

Shërbimi i SNS-së në kohën raportuese Janar- Qershor 2026 ka pasur një rënje në kërkesa për ndihmë sociale krahasuar me periudhen e njejtë të vitit të kaluar.

Në muajin Janar kanë qenë 889 familje në Skemën e Ndhmës Sociale,Shkurt 892,Mars 879,Prill 868 Maj 867 dhe Qershore 874,

Në këtë periudhë kohore nga 01/01/2026 deri me 30/06/2026 janë gjetur gjithësejtë 24 familje që kanë realizuar NS në mënyrë të jashtëligjshme (krahasim i të dhënave me ATK-në e të cilat familje menjëher largohen /nga ndihma sociale)
Prej të cilave 4 është riaktivizuar.

Kërkesat e reja: Prej dt.01/01/2026 gjerë me dt.30/06/2026 janë parashtruar 70 kërkesa për Ndhimë Sociale prej te cilave për kategorinë e I-rë 54 e për /kategorinë e II-të 16 familje.

Riaplikimet:Në periudhën kohore prej dt. 01/01/2026 gjerë me dt.30/06/2026 kanë dalë në riaplikim 358 familje:Janar 100 familje,Shkurt 141 familje, Mars 108 familje,Prillë 114 familje Maj 87 Qershor 81.

Verifikimi dhe Riverifikimi i familjeve:Familjet të cilat realizojn Ndhmën Sociale si dhe familjet qe paraqesin kërkesë për ndihmë sociale verifikohen në afatin kohor prej 45 ditësh. Familjet aktive të kategorisë së I-rë riverifikohen një herë në vitë kur e bëjnë riaplikimin, ndërsa familjet e kategorisë së II-të riverifikohen çdo 6 muaj kur e bëjnë riaplikimin.

Janë verifikuar për herë të parë 70 familje si dhe janë riverifikuar të gjitha familjet qe kanë riaplikuar në periudhen nga Janari/2026 deri Qeshor/2026.

Aprovimet:Gjerë me dt.31/06/2026 janë aprovuar 58 familje në Ndhmë Sociale.

Refuzimet:Nga kërkesat e reja për NS janë refuzuar 12 familje.

Rishqyrtim:Në rishqyrtim janë 5 kërkesa të cilat ende nuk ju kanë nënshtruar komisionit mjekësor regjional ose nuk kanë dal ende në teren për verifikim.

Ndërprerje e Ndhmave Sociale:Ndihma Sociale ju ka ndërprerë 30 familjeve për këtë periudhë e shkaku është qe nuk i plotësojnë njerin prej kriterëve të Ligjit për Skemën e Ndhmës Sociale ose punësim i ndonjë anëtarit të familjes, përmirësim i gjendje ekonomike të familjes, shkuarje në boten e jashtme si dhe mosha 65 vjeqare qe kalojnë në PB etj.

Komisioni mjekësor:Në këtë periudhë kohore janë mbajtur 6 seanca të komisionit mjekësor në nivelin regjional janë shqyrtuar 1287 aplikacione të komisionit mjekësor dhe prej tyre në Janar 191,Shkurt 266,Mars 231, Prill 222,Maj 222 dhe Qershor 155

Në këtë periudh kohore QPS-Pejë ka pasur 333 kërkesa për shqyrtim në komisionin mjekësor regjional. Për muajin Janar ka pas 55 kërkesa,Për muajin Shkurt ka pas 94 kërkesa ,Për muajin Mars ka pas 53 kërkesa.,Prill 37kërkesa,Maji 54 kërkesa dhe Qershori 40 kërkesa.

Kërkesa për rishqyrtim:Në këtë periudhë kohore janë paraqitur 5 kërkesa për rishqyrtim jane ne procedure per marrjen e vendimit.

Shkalla e II-të e ankesave DPSF:Në këtë periudhë kemi 5 ankesa prej tyre

Ankesa për Gjykatën Themelore: Kemi 0 ankesë.

Ndihma e njëhershme (Emergjente):Në këtë periudh kohore prej 01/01/2026 deri me dt.30/06/2026 nuk kemi pasë kërkesa për ndihmë të njëhershme.

Çertifikata për student:Nuk ka pas.

Çertifikata: Nga ky sherbim janë leshuar 180 çertifikata për shfrytëzuesit e NS si dhe për ata që nuk realizojn NS ose për marrjen e Shtetësisë në Republikën e Kosovës etj.

2. Zyrtarët e Sherbimit të Asistencës Sociale me datë 29/01/2026 kanë përpiluar listat për 70 familje të cilat janë shfrytëzuese të ndihmës sociale nga donatoret OJQ Islamic Relief si dhe donatore individual me pako ushqimore, me datë 23/02/2026 pako ushqimore për 10 familje, 25/05/2026 janë shpërndar pako për 50 familje dhe me dt.26/06/2026 janë shpërndarë 60 pako ushqimore

Shërbimi i asistencës sociale është i kyqur edhe në punën e SAS- Pilot Projekt program nga niveli qendror bazuar në aplikimet online për muajin Qershorë ka ardhë lista me 247 familje të cilat janë përfitues dhe te refuzuar 13 aplikant.

Albulena Mujaj-Bajraktaraj
Drejtorja për Mirëqenie Sociale



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ

DREJTORIA PËR PUNË INSPEKTUESE

**RAPORTI GJASHTË-MUJOR I DREJTORISË PËR PUNË INSPEKTUESE
PËR VITIN 2026**

Qershor, 2026

Raporti i hartuar është bazuar dhe mbështetur në kompetencat ligjore dhe përshkrimin të punës si dhe në zbatimin e Planit të Veprimit për Vitin 2026.

DREJTORIA PËR PUNË INSPEKTUESE (DPI)

Objektivat

- **Angazhimi maksimal për kryerjen e detyrave dhe përgjegjësi të cilat i kemi si Drejtori brenda kuadrit të kompetencave ligjore .**
- **Kryerja e punëve inspektuese konform ligjeve në fuqi.**
- **Bashkëpunimi me organet e rendit dhe sigurisë në rastet kur duhet të intervenojmë dhe paraqitet rrezikshmëria.**
- **Rritja e transparencës.**

DPI është përgjegjës për mbikëqyrjen dhe zbatimin e ligjeve dhe rregulloreve komunale në lëmin e:

- a) Inspektoratit Komunal të Komunikacionit; b) Inspektoratit Komunal; c) Inspektoratit Komunal të Ndërtimit; dhe d) Inspektoratit Komunal të Mbrojtjes së Mjedisit.

ORGANIZIMI I DREJTORISË PËR PUNË INSPEKTUESE

- 1. Sektori i Komunikacionit në kuadër të së cilit veprojnë Inspektorët Komunal të Komunikacionit.**
- 2. Sektori Komunal në kuadër të së cilit veprojnë Inspektorët Komunal.**
- 3. Sektori i Ndërtimit në kuadër të së cilit vepron Inspektori Komunal i Ndërtimit.**
- 4. Sektori i Inspektoriatit të Mbrojtjes së Mjedisit në kuadër të së cilit veprojnë Inspektorët Komunal të Mbrojtjes së Mjedisit.**

Planet e Veprimit planifikohen në fillim të vitit kalendarik për secilin Sektor përkatës dhe organizohen aktivitete (plane operative) në bazë të periudhave sezonale, ankesave dhe kërkesave të qytetarëve gjithmonë me të vetmin qëllim që të zgjedhim problemet e qytetarëve, të jemi pranë tyre dhe të evitojmë pengesat ligjore duke ndërmarrur masat e nevojshme në kuadër të kompetencave Ligjore.

PUNA GJASHTË-MUJORE E INSPEKTORAVE TË KOMUNIKACIONIT

Inspektor i Komunikacionit:

Pajazit Shala.

Kompetencat e Inspektorëve të Komunikacionit

Mbikëqyrja dhe zbatimi i dispozitave ligjore nga lëmi i komunikacionit rrugor siç janë;

- Ligji Nr. 04/L-179 Mbi Transportin Rrugor;
- Ligji Nr.2003/11- Ligji për Rrugët;
- Ligji Nr.05//L-088 për Rregullat e Trafikut Rrugor;
- Ligji Nr.02/L-70 Siguria në Komunikacionin Rrugor;
- Rregullorja Komunale Nr.02/2019 për Transportin Rrugor
- Rregullorja Komunale Nr.03/2019 për Transportin Rrugor.

Ndër të tjera kompetenca që ushtrohen janë inspektimi i qarkullimit publik rrugor, inspektimi dhe kontrollimi i automjeteve që ushtrojnë veprimtari shërbyese (taksi), stacionin e autobusëve, lejet e punës, kontratat, dokumentet e transportit dhe dokumentet tjera që kanë të bëjnë me punën dhe veprimtarinë e ndërmarrjeve; Kujdeset për organizimin dhe mbarëvajtjen e rregullt të transportit rrugor brenda territorit të komunës si dhe punë të tjera.

RAPORT I PUNËS

Për muajin Janar – Qershor 2026

Inspektorët:

- Pajazit Shala
- Salih Kelmendi
- Xhevat Nikqi

Gjatë periudhës janar–qershor 2026, inspektorët e komunikacionit kanë zhvilluar aktivitete të vazhdueshme mbikëqyrëse në zbatim të legjislacionit në fuqi. Gjatë kontrolleve të realizuara janë evidentuar këto rezultate:

- Janë shqiptuar **13 gjoba mandatore** në vlerë prej **200 €**, sipas dispozitave ligjore në fuqi.
- Janë shqiptuar **2 gjoba mandatore** në vlerë prej **100 €**.
- Janë lëshuar **15 njoftime zyrtare**.
- Janë kryer **80 kontrolle të rregullta** në terren.
- Janë realizuar **3 pezullime të licencave**.
- Janë pranuar dhe trajtuar **8 kërkesa**, prej të cilave:
 - **3** janë aprovuar;
 - **1** është në procedurë shqyrtimi;
 - **4** janë refuzuar.

Përfundim:

Gjatë kësaj periudhe, aktivitetet inspektuese janë zhvilluar në përputhje me planin e punës dhe kompetencat ligjore të Inspektoratit të Komunikacionit. Qëllimi i kontrolleve ka qenë sigurimi i zbatimit të legjislacionit, rritja e disiplinës në transport dhe trajtimi i kërkesave të palëve në mënyrë të rregullt dhe Planet Operative me Policin e Kosovës.

1. Sektori i Inspeksionit Komunal

Udhëheqës i Sektorit të Inspeksionit Komunal: **Vllaznim Pergjegjaj**

Inspektorët Komunal: Ali Kurtaj, Alfrid Uka, Arbenitë Zeneli, Blerta Lajqi, Gentiana Zallqi, Miranda Luta , Veton Dervishaj.

Sipas përshkrimit të vendit të punës kompetencat e Inspeksionit Komunal janë:

- Parandalimi i rrehimjës së sipërfaqes publike pa leje nga organi kompetentë.
- Parandalimi i derdhjes së ujit pa arsyje nëpër rrugë dhe trotuare .
- Parandalimi i vendosjes së reklamave pa leje nga organi kompetentë.
- Parandalimi i vendosjes së tavolinave para kafiterive pa leje nga organet kompetente.
- Largimi i shitësve ambulant nga sipërfaqja publike .
- Parandalimi i vendosjes së materialit ndërtimor në sipërfaqe publike.
- Mbikëqyrja e pastërtisë para hapësirave afariste.

Në këtë periudhë kohore është punuar sipas planeve javore dhe janë lëshuar në total:

Nr.rendor.	Aktivitetet e Inspektimit	Numri i Procesverbaleve
*1	Reklama	376
*2	Tavolina në sipërfaqe publike	68
*3	Pengesa në sipërfaqe publike-larguar	10
*4	Rrëmihje në sipërfaqe publike	1
*5	Gjenerator në sipërfaqe publike	2
*6	Parkingje.	/
*7	Mall në sipërfaqe publike- ose (pemë perime)	/
*8	Uji - Sipërfaqe publike	/
*9	Gjoba për kanalizim 2026	/
*10	Gjoba për mall 2026	4
*11	Gjoba për reklama 2026	/
*12	Gjoba për tavolina 2026	/
*13	Gjoba për rrëmihje (prerje e asfaltit)	/
*14	Gjoba për pengesa 2026	/
*15	Kërkesa dhe ankesa të palëve	29
Total numri i inspektimeve:		490

2. Sektori i Inspeksionit për Mbrojtjen e Mjedisit

Udhëheqës i Sektorit të Inspeksionit të Mbrojtjes së Mjedisit: Galdim Krasniqi

Inspektorët e Sektorit Komunal për Mbrojtjen e Mjedisit: **Blendi Kadusha, Besfort Mema, Miftar Shala dhe Xhevat Nikqi.**

Gjatë kësaj periudhe është punuar sipas Planit të Veprimit që është paraparë sipas detyrave dhe përgjegjësi mbështetur në Ligjet dhe Rregulloret për Mbrojtjen e Mjedisit, si dhe në bashkëpunim me Drejtorin e Inspeksionit. Inspeksioni Komunal i Mjedisit në bazë të organogramit (përshkrimi të detyrave të punës) merret me: Mbrojtja e mjedisit nga hudhja e mbeturinave në sipërfaqe publike dhe private, mbrojtja e mjedisit nga degradimet dhe nga ndotja e ajrit, mbrojtja e mjedisit nga shfrytëzimi i resurseve natyrore (rërës dhe zhavorrit) në menyre ilegale, mbrojtja e mjedisit nga shkarkimi i ujrave të zeza në ambiente të hapura, Mbrojtja e mjedisit nga ndotja akustike (zhurma).

Inspeksioni Komunal i Mbrojtjes së Mjedisit bazohet dhe vepron sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve që janë në fuqi.

Ligjet të cilat implementohen nga Inspektorët Komunal për Mbrojtjen e Mjedisit janë:

- LIGJI Nr.04/L-060 PËR MBETURINA
- LIGJI Nr.08/L-071 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT Nr.04/L-060 PËR MBETURINA
- LIGJI Nr. 03/L-025 PËR MBROJTJEN E MJEDISIT.
- LIGJI Nr. 08/L-025 PËR MBROJTJEN E AJRIT NGA NDOTJA.
- LIGJI Nr. 02/L-102 PËR MBROJTJEN NGA ZHURMA
- RREGULLORE KOMUNALE Nr. 11/2015 PËR MBROJTJEN E MJEDISIT.
- RREGULLORE KOMUNELE Nr. 01/2023 PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE.
- RREGULLORE KOMUNALE Nr. 02/2023 (KPE) PËR TAKSAT KOMUNALE.

KONTROLLA TË RREGULLTA	63
KONTROLLA ME PROCESVERBAL	45
KËRKESA TË PALËVE	13
KËRKESA TË PËRFUNDUARA	13
KËRKESA NË PROCEDURË	00
GJYKATA KOMERCIALE	01
NUMRI I GJOBAVE TË SHQIPTUARA	07
NUMRI I GJOBAVE TË PAGUARA	05
NUMRI I GJOBAVE TË PAPAGUARA	02

MENAXHIMI I MBETURINAVE		
KËRKESA TË PALËVE 05	KONTROLLA ME PROCEVERBAL 17	GJOBA 10

MENAXHIMI I MJEDISIT (MBROTJA E RESURSEVE NATYRORE)		
KËRKESA TË PALËVE 01	KONTROLLA ME PROCESVERBAL 07	GJOBA 03

NDOTJE AKUSTIKE, FEKALE, NDOTJE E AMBIENTIT(DJEGIE)		
KËRKESA TË PALËVE 14	KONTROLLA ME PROCESVERBAL 20	GJOBA 01

3. Sektori i Ndërtimit

Gjatë kësaj periudhe gjashtë-mujore ka qenë i angazhuar në punët e Sektorit të Ndërtimit, Inspektori i Ndërtimit **Burim Kelmendi** i cili ka vepruar në kuadër të kompetencave ligjore sipas detyrave dhe përgjegjësi për mbikëqyrjen inspektuese në fushën e ndërtimeve, ndalimin e punimeve ilegale dhe rrënimin e tyre, si dhe punë të tjera të përcaktuara me ligje dhe akte tjera nënligjore në fuqi.

Inspeksioni i Ndërtimeve në kufijtë e mundësive dhe autorizimeve të veta dhe duke u bazuar në ligjin e ndërtimit Nr.04/L-110 Ligjin e Inspektoratit Nr.04/L-175 si dhe në bazë Udhëzimeve Administrative pandërprerë ndërmerr masa për evitimin e ndërtimeve pa leje të ndërtimit .

Për objekte që posedojnë lejen e ndërtimit është bërë inspektim i vazhdueshëm gjatë ndërtimit se nëse bëhet ndërtimi në pajtim me kushtet urbanistike dhe dokumentacionin teknik në bazë të cilit është dhënë leja e ndërtimit .

Për objektet ilegale është bërë përgaditja dhe shpërndarja e aktvendimeve me të cilët urdhërohen palët për ndërprerjen e punëve dhe njëkohësisht njoftohen për procedurën e rregullt lidhur me parashtrimin e kërkeses si dhe për marrjen e lejes së ndërtimit nga organi kompetent.

Për ata pronar të objekteve, që nuk i kanë respektuar vendimet për ndërprerjen e punëve, Inspeksioni i Ndërtimit në bashkëpunim me asistimin e organeve Policore ka bërë ndërprerjen e punëve pa leje dhe mbylljen e punishteve të ndërtimit (objekteve) ,është bërë kërkesë për hapjen e procedurës për kundërvajtje si dhe ka bërë kallëzime penale.

Gjatë kësaj periudhe ka pasur kërkesa e ankesa të natyrave të ndryshme , ku të gjitha janë shqyrtuar dhe janë ndërkshuar sipas ligjeve të ndërtimit në fuqi.

Inspektori i Ndërtimit angazhohet maksimalisht për inspektimin e të gjitha bashkësive territoriale çdo ditë pune po ashtu edhe gjatë ditëve të vikendit për evitimin e ndërtimeve pa leje.

OBJEKTE TË INSPEKTUARA	TOTAL 268 OBJEKTE
Objekte të inspektuara të kategorisë së I-rë (Objekte individuale)	120 Objekte
Objekte të inspektuara të kategorisë II-të (Objekte kolektive)	32 Objekte
Inspektim final Kategoria e II-të	2 Objekte
Në 4 objekte ka qenë e nevojshme intervenimi dhe marrja e masave	4 Objekte
- Kërkesa për inspektim të fazave	110 Kërkesa-Ankesa
- Ankesa të ndryshme të qytetarëve	Të gjitha janë të shqyrtuara.

Drejtoria për Pune Komunale dhe Sherbime Publik		
Agron Nikçi		Janar-Korrik 2026
Agron.nikci@rks-gov.net 044-774-111		DATA: 14.07.2025

Nr. Ref.	Emërtimi i projektit kapital	Muaji- Viti i realizimit, përshkrimi i punëve përfshirë procedurën e prokurimit.
1	Mirëmbajtja, e rrugëve ne Qytet dhe Fshat.	Mirembajtja e rrugeve dhe hapesirave publike eshte në fazën e procedurave të prokurimit për nënshkrimit e kontratës për 36 muaj.
2	Mirëmbajtja dhe shenjëzimet të komunikacion ne rrugët lokale.	Mirëmbajtja dhe shenjëzimet të komunikacion ne rrugët lokale eshte kontraktuar kete vite me kohezgjatje kohere 24 muaj. Kemi intervenuar ne shenjezimi horizontal dhe vertikal ne disa rruge ne qytet, disa rruge jane shenjezuar pasi qe jan asfalttuar dhe disa ju eshte rregulluar shenjezimi egzistuese pasi kan qen te demtuara. Ne bashkpunim dhe me policin e Kosves eshte bere nje plan qe ne vitin e ardheshem te behet shenjezimi ne disa lokacione te caktuara ku shihet qe paraqesin rrezik per qytearet.
3	Mirëmbajtja e ndriçimit publik.	Jane nënshkruar dy kontrata për mirëmbajtjen e ndriçimit publik , njëra furnizim me matrial elektrik me afate prej 12 muaj dhe njëra kontrat per punë per mirëmbajtjen e ndriçimit publik me afat prej 24 muaj.
4	Ndertimi i rruges Poqest - Doberdol	Jane inicuar procedurat e prokorimit dhe është ne fazen e nenshkrimt te kontrates.
5	Ndërtimi i rrugës Lipë e Vogël	Jane inicuar procedurat e prokorimit dhe është ne fazen e nenshkrimt te kontrates

6	Ndërtimi i rrugës Zagerm - Lubeniq	Jane inicuar procedurat e prokorimit dhe është në fazën e nënshkrimit të kontratës.
7	Rindërtimi i Murit të lumit dhe mveshja e murit me gure	Mveshja me gure të murit të lumbarshit ka vazhduar ku është përfunduar mveshja me murin patrikana deri tek Ura "Zlekiqve", punët do të vazhdojnë dhe në vitin 2026.
8	Asfaltimi i Rrugës Sejnovë – Gjorë	Ndërtimi i rrugës në fshatin Jabllanik të madhë që të derdhen në drejtim të bjeshkës Sjonovë- Gjorë ka filluar bëhet, punët përgaditore, hapja dhe shtrimi e trases ndërtimi i mureve mbrojtëse, kontrata për përfundimin e projektit do të vazhdojë dhe në vitin 2026.
9	Ndërtimi i Kanalit në lagjen Asllan Ceshmë.	Punimi i kanalit në rrugën "Asllan Qeshmë" janë kryer punët e rrenimit të kanalit egzistues dhe është bërë rindërtimi i kanalit të ri me dimensione më të mëdha për shkak të rritjes së kapacitetit, kanali është në përfundim të pjesës së planifikuar, ndërsa në vitin 2026 do të vazhdohet me punimin e pjesës tjetër të kanalit të hapur ku ka pas problem pronarësh dhe do të rrenohen disa objekte në pronë të kanalit.
10	Ndërtimi i sheshit prej Ures së Zallit deri të Ura të re (Hajdaragët)	Ky projekt është në dy faza, një fazë është projektimi i këtij projekti ku është në fazën finale të projektimit dhe faza tjetër është iniciimi i procedurave për punë në këtë projekt.
11	Ndërtimi i rrethojave të varrezave nëpër fshatrat e Komunes së Pejës	Jane inicuar procedurat e prokorimit dhe është në fazën e nënshkrimit të kontratës.
12	Ndërtimi i Kanalizimit në lagjet Kapeshnice, Lagjen e Gurit, Lagjen Kristal, Fshatin Baran.	Vendosja e kanalizimit në qytet dhe fshatra ka përfunduar dhe funksionalizuar në disa lokacione të parapara, vitin 2026 pritet të përfundojë në teresi kontrata.
13	Ndërtimi i Kanalizimit Raushiq-Loxhe - impiant.	Ndërtimi i kanalizimit është në ekzekutim e sipër ku ka filluar të vendoset rrjeti nga fshati Gorozhevc në drejtim të fshatrave Raushiq dhe Loxhe, pasi që kemi disa probleme pronarësh projekti do të përfundojë në vitin 2026.

1 4	Ndertimi i rrugëve në Novosell, Jabllanic e Madhe, Jabllanic e Vogel, Dubovë dhe Radac.	Punimet kanë vazhduar dhe kanë përfunduar në disa fshatra të parashikuara me kontrata, punimet për realizimin dhe përfundimin e kontratës do të vazhdojnë në vitin 2026.
1 5	Ndërtimi i rrugës në Maja e Zezë	Jane inicuar procedurat e prokurimit dhe është në fazën e nënshkrimit të kontratës.
1 6	Nërt. i rrug. në Nabërgjan, Terstenik, Ruhot, Zahaq, Llabjamn, Katund i Ri dhe Qyshk.	Punimet kanë vazhduar dhe kanë përfunduar në disa fshatra të parashikuara me kontrata, punimet për realizimin dhe përfundimin e kontratës do të vazhdojnë në vitin 2026.
1 7	Ndërtimi i rrugës në fshatin Dushkajë	Jane inicuar procedurat e prokurimit dhe është në fazën e nënshkrimit të kontratës.
1 8	Ndërtimi, renovimi i rrugëve dhe trotualet në Qendër të qytetit, Lagjet Puhovc, Karagaq, Jarine, Xh.Kadë, Spitalit, Kristal dhe 7 Shtator	Jane inicuar procedurat e prokurimit dhe është në fazën e nënshkrimit të kontratës.
1 9	Asfaltimi i anekseve të rrugëve në fshatrat e Rugovës (Shtupeq i Madh, Shtupeq i Vogël dhe Malaj)	Jane inicuar procedurat e prokurimit dhe është në fazën e nënshkrimit të kontratës.
2 0	Ndërtimi i rrugëve në lagjet Karagaq, Kapeshtice dhe Puhovc, Jarine, Asllan Çeshme, Xh.Kada dhe Kristal.	Punimet kanë vazhduar dhe kanë përfunduar në disa fshatra të parashikuara me kontrata, punimet për realizimin dhe përfundimin e kontratës do të vazhdojnë në vitin 2026.
2 1	Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës "Varri i Sykut – Bellopaq".	Jane duke vazhduar punët për përgatitjen e trasesë dhe asfaltimit të tyre, kontrata vazhdon dhe në vitin 2026.
2 2	Asfaltimi i anekseve të rrugëve në fshatrat e Rugovës (Stankaj, Boge, Shkrel)	Jane duke u punuar projektet, paramasat dhe paralogarit për nisjen e procedurave të prokurimit.
2 3	Asfaltimi i anekseve të rrugëve në fshatrat e Rugovës (Kuqisht, Koshutan, Drelaj, Pepaj)	Jane duke u punuar projektet, paramasat dhe paralogarit për nisjen e procedurave të prokurimit.
2 4	Ndërtimi i impiantit në Jabllanicë të Leshanit	Jane inicuar procedurat e prokurimit dhe është në fazën e tenderimit dhe procedurave për nënshkrimin e kontratës.
2 4	Ndërtimi i rrugëve në fsh. e Lugut të Baranit, Leshanit, Trestenikut dhe Radacit	Jane duke u punuar projektet, paramasat dhe paralogarit për nisjen e procedurave të prokurimit.

2 5	Ndërtimi i rrugës Peklenë – Shtupeq i Vogël- Varri Sykut (faza2)	Punët janë duke vazhduar ne përgatitjen e trasesë kontrata do te vazhdoje dhe ne vitin 2026 (Bashkëfinancim me MI)
2 6	Ndërtimi i rrugës ne Drelaj- Leqinat.	Punët janë duke vazhduar ne përgatitjen e trasesë kontrata do te vazhdoje dhe ne vitin 2026 (Bashkëfinancim me MI)
2 7	Rekostruimi i rrjetit ne fshatrat e Rugovës	Kontrata është duke u realizuar, punimet janë në finalizim për përfundimin e projektit, funksionalizimi i rrjetit në disa lokacione ka përfunduar gjatë vitit 2024, ndërsa përfundimi i plotë i projektit do të bëhet në fillim të vitit.
2 8	Ndërtimi i ujësjellësit ne Lugun e Baranit.	Punët kanë vazhduar në ndërtimin e rrjetit të ujësjellësit dhe janë ne përfundim, per shkak te te procedurave per paisje me leje Ujore dhe mjedisore kontrata pritet të finalizohet ne muajt ne vazhdim gjate vitit kalendarik 2025.
2 9	Ndërtimi për ndriçim publik me panele solare në Sferk, Lutogllavë dhe Gorozhdec	Jane duke u punuar projektet , paramasat dhe parallogarit per nisjen e procedurave te prokurimit.
3 0	Ndërtimi i rrugës Qafë Hajle- Varri i Syk	Jane duke u punuar projektet , paramasat dhe parallogarit per nisjen e procedurave te prokurimit.
3 1	Rregullimi i infrastrukturës publike në zonat industriale të Brestovikut, Sferrkës, Zahaqit, Lugun e Baranit, Lugun e Leshanit, Podgurit, Rugovë, Lipë, Qendra Zejtare, Rrokaqielli dhe 7	Kontrata është kontraktuar këtë vite dhe kane filluar punimet ne ndërtimin e vrazhdë dhe ne punet finale, punët për finalizimin e kontratës do te vazhdoj dhe ne vitin 2026 .
3 2	Ndërtimi i shtëpisë se fshatit Nabergjan dhe Radavc (lagjeja Avdylaj)	Jane inicuar procedurat e prokorimit dhe është ne fazen e nenshkrimit te kontratës.
3 3	Mirëmbajtja e rrugëve ne fshatrat e Rugovës .	Eshte nënshkruar kontrata per 36 muaj dhe se shpejti fillojn punimet ne mirëmbajtjen e te gjitha rrugëve ne zonën e Rugovës.
3 4	Ndertimi i mureve mbrojtëse ne lagjet :Dardania , Kapeshnic dhe Xhemajl Kada – Komune e Pejës	Jane inicuar procedurat e prokorimit dhe është ne fazen e tenderimit.

Agron Nikçi

DRAFT



Drejtoria e Shëndetësisë - Pejë

Referencë:	
Për/Za/To:	z.Gazmend Muhaxheri-Kryetar I Komunes
Data/Datum/Date:	14.07.2026
Nga/Od/From:	Dr.Petrit Loci- Drejtor i Shëndetësisë
Tema/Subjekat/Subject	Raport gjashtë mujor janar - qershor 2026

Raporti i punes per 6 mujorin e vitit 2026 ka të beje me punën e Drejtorise se Shëndetesisë dhe nënprogramit të saj QKMF-së



2. Përmbledhja ekzekutive:

Roport pune

Drejtoria e Shëndetësisë në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, si dhe mbështetur në udhëzimet strategjike dhe politike të Kryetarit të Komunës ,në kuadër të fushë veprimtarisë së saj ushtron dhe është përgjegjëse për ndërmarrjen e masave dhe aktiviteteve specifike për të arritur objektivat e si Drejtori i QKMF-së

Drejtori ka udhëhequr proceset menaxheriale dhe ka mbikëqyrur funksionimin e përgjithshëm të institucionit. Gjatë gjashtë mujorit, ka zhvilluar takime të rregullta me njësitë përkatëse, ka ndjekur zbatimin e planeve të punës, si dhe ka përfaqësuar institucionin në takime me autoritete komunale dhe partnerë të tjerë të fushës së shëndetësisë

1. Përmbledhje Ekzekutive

Gjatë periudhës Janar–Qershor 2026, QKMF Pejë ka ofruar shërbime shëndetësore primare për qytetarët, duke siguruar kujdes të vazhdueshëm dhe cilësor në të gjitha njësitë. Aktivitetet janë fokusuar në shërbime ambulatorë, kujdes parandalues, vaksinim dhe menaxhim të sëmundjeve kronike.

2. Shërbimet Kryesore (Statistika të përgjithshme)

Nr. Rendor	Departamenti (SHERBIMI)	Vizitat																
		Ne ordinancë														Vizita Shtëpiake		
		Mjeku													Sherbimet tjera shendetesore (infirmieri),	Mjeku	Punëtor et tjere shendet	
		Gjithsej	Vizitat e para sipas moshës															
			Gjithsej	< 1 vjet	1 - 5	6 - 9	10 - 14	15 - 19	20 - 24	25 - 34	35 - 44	45 - 54	55 - 64	65+ vjet	Panjohur			
1	Mjekësia Familjare	0	77120	170	1175	1630	3023	4127	5670	7355	9105	12850	12985	19030	0	26.561	0	1729
2	Pediatria	0	6478	1685	2193	1255	1162	173	1	9	0	0	0	0	0	0	0	0
3	Gjinekologji	0	227	0	0	0	4	8	19	29	65	61	14	27	0	0	0	0
4	Vaksinimi + Covid 19	0	7042	1174	783	753	1013	1098	256	302	355	396	422	490	0	0	0	0
